

MONITORIMI I PËRDORIMIT TË FJALËVE TË HUAJA NË MEDIAT AUDIOVIZIVE



Albanian Media Institute
Instituti Shqiptar i Medias



AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

MONITORIMI I PËRDORIMIT TË FJALËVE TË HUAJA NË MEDIAT AUDIOVIZIVE



Tiranë, 2025

Ky projekt është mundësuar me mbështetjen financiare të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Përmbajtja e tij është përgjegjësi e autorit, opinionin i shprehur në të nuk është domosdoshmërisht opinion i Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Grupi i punës për këtë botim u drejtua nga
Prof. Asoc. Linda Mëniku

Kopertina dhe faqosja: Bujar Karoshi

ISBN 978-9928-469-56-4

Botues:

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	5
2. HUAZIMET	12
2.1 Huazime nga italishtja	13
2.2. Frekuenca e përdorimit të italianizmave në media	15
Përfundime	63
3. HUAZIMET NGA GJUHA ANGLEZE	66
3.1. Frekuenca e përdorimit të anglicizmave në media	72
3.2 Titujt e emisioneve	101
Përfundime	104
Bibliografia	106

I. HYRJE

Autoriteti i Mediave Audiovizive përmes fushatës “Fol Shqip” ka pasur në qendër të vëmendjes përdorimin e fjalëve të huaja në media me qëllim ruajtjen e pastërtisë së gjuhës shqipe, si dhe ndërgjegjësimin e gazetarëve dhe të gjithë punonjësve të medias për rëndësinë e përdorimit të fjalëve të gjuhës shqipe.

Në kuadër të kësaj fushate, Instituti Shqiptar i Medias, me mbështetjen e Autoritetit të Mediave Audiovizive, ka realizuar studimin e mëposhtëm, me fokus monitorimin e përdorimit të fjalëve të huaja në mediat audiovizive, me synimin për të dokumentuar dhe analizuar nga ana statistikore prirjet e përdorimit të fjalëve të huaja në media.

Media, si pushtet i katërt ka një ndikim shumë të madh në formimin gjuhësor të lexuesve, prandaj studimet për median janë shumë të rëndësishme për të kuptuar prirjen e përgjithshme të shqipes sot dhe mënyrën sesi mund të ndikohet në formimin gjuhësor të shqiptarëve.

Në këtë studim janë marrë në shqyrtim dhe është analizuar përdorimi i fjalëve të huaja në disa nga mediat audiovizive shqiptare (TV Klan, Top Channel, News 24, Report TV, Euronews, RTSH, Panorama).

Në përzgjedhjen e bërë janë marrë në konsideratë disa kërkesa që duhej të plotësonin këto media: a) të kishin një audiencë kombëtare, në të gjithë territorin e vendit,

b) të kishin faqe interneti me motor kërkimi, c) të ishin media me audiencë të lartë.

Fokusi i këtij studimi kanë qenë lajmet në media. Dhe për të realizuar një monitorim të plotë të tyre janë marrë në shqyrtim faqet e internetit të këtyre mediave.

- **Balkanweb.com-News 24** e cila mbulon me lajme të gjitha kategoritë: Shqipëri, Kosovë, politikë, aktualitet, sociale, ekonomi, sport, kronika, lajmi i fundit, periferi, rajon, bota, analiza.
- **Euronews.al**- faqja online e televizionit Euronews Albania.
- **Tvklan.al** - faqja e internetit e “TV Klan” që përmban lajme, si dhe informacione mbi programet e “TV Klan” dhe “TV Klan Plus”.
- Për të pasur një panoramë edhe më të plotë, në këtë studim është përfshirë dhe faqja online e gazetës “Panorama”, gazeta më e madhe në vend, që tani ka dhe kanalën “Panorama TV”, **Panorama.com.al**.
- **Top-channel.tv** - faqja e internetit e televizionit Top Channel.
- **Rtsh.al** - faqja e internetit e Radio Televizionit Shqiptar.
- **Report-tv.al** - faqja e internetit e Televizionit Report TV.

Ky studim synon të hulumtojë dhe të analizojë frekuencën e përdorimit të fjalëve të huazuara nga gjuhë të tjera në median audiovizive shqiptare. Duke u bazuar në studimet e mëparshme për huazimet

në gjuhën shqipe, studimi ka si synim të sjellë një panoramë më të plotë dhe të më të detajuar në lidhje me dendurinë e përdorimit të fjalëve të huaja në gjuhën shqipe. Më konkretisht, në këtë studim është shqyrtuar frekuenca e huazimeve në:

- a) në media të ndryshme
- b) në lajme të kategorive të ndryshme (politikë, kulturë, sport etj.)

Në këtë studim është monitoruar frekuenca e përdorimit të fjalëve të huaja, gjë që ndihmon për të kuptuar më mirë dhe prirjet e sotme të përdoruesve të gjuhës.

Faqet e internetit *balkanweb.com*, *tvklan.al*, *euronews.al*, *panorama.com.al* kanë motorë kërkimi që japin mundësi për marrjen e të dhënave statistikore në arkivin historik të tyre, prandaj dhe ky studim është bazuar në të dhënat statistikore të mbledhura në këto media.

Sigurisht që çdo media ka një historik kërkimi për një periudhë kohore të caktuar, prandaj të dhënat statistikore që do të parashtrohen në këtë studim, nuk janë në funksion të krahasimit të frekuencës së përdorimit të fjalëve të huaja në mediat e ndryshme, por krahasimi i fjalëve të huaja dhe të shqipes, brenda së njëjtës media, për të kuptuar prirjen e sotme gjuhësore.

Motorët e kërkimit në faqet *balkanweb.com*, *tvklan.al*, *panorama.com.al*, *euronews.al*, kanë krijuar mundësinë e kërkimit në arkivat historikë të faqeve të internetit, dhe sigurojnë paraqitjen e të dhënave për lajmet nga periudha të ndryshme.

Kështu, në faqen tvklan.al, jepet mundësia e kërkimit të fjalëve për periudhën 1996-2025. Madje, është e vetmja faqe, në të cilën mund të merren të dhëna statistikore edhe në lidhje me frekuencën e përdorimit të fjalëve në secilin vit, gjë që ka ndihmuar për ta bërë edhe më të plotë këtë studim, pasi është analizuar frekuenca më e lartë e përdorimit të fjalëve të huaja dhe prirja e tyre, në rritje ose në rënie.

Figura 1. Motori i kërkimit, tvklan.al



Faqja e internetit balkanweb.com, nuk i ka të përcaktuara vitet e përfshira në arkivin e lajmeve, por duket se përfshin periudhën nga viti 2007 deri në janar dhe shkurt 2025.

Faqja e internetit euronews.al duket se përfshin arkivin e lajmeve që nga themelimi i këtij televizioni në vitin 2019, pra periudhën 2019-2025.

Fjalët e analizuara kanë bashkëjetuar mes tyre në periudha të gjata dhe janë të përfshira në fjalorët e gjuhës shqipe. Ato nuk janë domosdoshmërisht fjalë të një sektori të caktuar, p.sh. vetëm të medias, por mund të jenë dhe fjalë të zakonshme të përdorura gjerësisht, por frekuenca e tyre është e dukshme mbi të gjitha në media.

Fokusi i këtij studimi është analiza krahasuese mes fjalëve të huazuara nga gjuhët e huaja dhe fjalëve gjegjëse në gjuhën shqipe, në të njëjtën media për të kuptuar se cila është prirja reale e përdorimit të tyre.

Në analizën statistikore janë marrë në konsideratë dhe disa nga format rasore të emrave dhe të trajtave foljore në kohë të ndryshme të mënyrës dëftore, nisur nga fakti që në tekstet e lajmeve, foljet përdoren kryesisht në vetën e tretë të njëjësit ose të shumës.

Van Dijk (2008) argumenton se në studimin e lajmit është e rëndësishme që të analizohen së bashku përdorimi i emrave dhe i foljeve në format veprorë dhe pësorë. Sipas Van Dijkut¹, gazetarët parapëlqejnë veçanërisht emrat për arsye të ndryshme si: mungesa e informacioneve për vepruesin, fokusi i autorit te veprimet, mungesa e hapësirës etj. (Van Dijk, 2008).

Përdorimi i fjalive “veprorë dhe pasive” dhe pozicioni i kryefjalës në fjali, janë tregues dhe të qëndrimit të mediave për aktorët e lajmeve dhe kanë një sërë funksionesh ideologjike.¹ Studime më të thelluara në lidhje me arsyet për këto zgjedhje dhe të preferencave

¹ Van Dijk, T.A. (2008). Critical discourse analysis and nominalization: Problem or pseudo-problem? *Discourse & Society*. 19(6), 821–828.

për fjali veprare, pësore apo emërore mund të bëhen në kuadrin e Analizës Kritike të Diskursit (CDA).

Për sa i përket preferencës së formave veprare dhe pësore nga gazetarët, Busa (2014) thekson se “forma veprare është forma e preferuar sepse i lejon gazetarit të përshkruajë veprimet në një mënyrë më të drejtpërdrejtë dhe më të lehtë për t’u kuptuar, pasi pasqyron mënyrën se si njerëzit mendojnë dhe përpunojnë informacionin³.

Karakteristikë e teksteve të lajmeve është përdorimi i foljeve në vetën e tretë të njëjësit ose të shumës, prandaj në analizën statistikore janë përfshirë vetëm format e vetës së tretë të së tashmes, të së kryerës së thjeshtë ose të së kryerës, të formave veprare dhe joveprare.

Në analizën statistikore janë përfshirë rezultatet e kërkimit të pjesoreve, pasi në disa raste këto forma janë dhe pjesë e formave të pashtjelluara dhe e mbiembrave dhe për të kufizuar mundësinë e gabimit në motorin e kërkimit, është analizuar vetëm frekuenca e përdorimit të pjesoreve dhe jo e trajtave të kohës së kryer të veprorës dhe të pësorës (p.sh. *ka/kanë miratuar-është/janë miratuar*).

Në analizën e lajmeve në media, gjuhëtarët kanë theksuar se përdorimi i emrave foljorë në vend të emra bëhet për t’u fokusuar te ngjarjet dhe situatat (Zucchi, 1993)⁴.

² Po aty.

³ Busa, G.M. *Introducing the language of the news: A student's guide*. Routledge. 2014, f.102.

⁴ Zucchi, A. *The language of propositions and events: Issues in the syntax and the semantics of nominalization*. Springer Science & Business Media. 1993.

Motorët e kërkimit japin mundësinë e gjetjes së fjalëve jo vetëm në tituj, por dhe në brendi të lajmeve, prandaj të dhënat statistikore janë të më të plota. (shih Fig.2).

Fig. 2. Rezultatet e kërkimit në tituj dhe në brendi të lajmit



2. HUAZIMET

Sipas Çabejit “nga përpjekjet e gjata të popullit shqiptar me të tjerë popuj, në Shqipëri brenda e në trevat përreth, gjuha shqipe ka pësuar ndikimin ku më të thellë ku më të cekët të gjuhëve të këtyre popujve. Ky element i huaj është një pasqyrë e gjallë e jetës së popullit shqiptar në marrëdhënie me popujt fqinj, dhe si e tillë ka rëndësi përveç se për gjuhësinë edhe për historinë shqiptare.”⁵

Gjuha shqipe ka marrë fjalë nga gjuhët me të cilat ka dhënë dhe ka marrë: nga greqishtja, latinishtja, e më vonë italishtja, nga të tjera gjuhë romane siç janë spanjishtja, frëngjishtja, dalmatishtja e rumanishtja etj.

Për Çabejin, ka qenë me rëndësi të dihen përpjesëtimet e elementit të huaj shikuar si një e tërë, duke u ndalur në raportet e elementeve të huaja me njëri-tjetrin dhe në raportin përpjesëtimor të elementeve të huaja ndaj visarit autokton të vendit.

Për kontaktin gjuhësor historik të shqipes me gjuhë të tjera (latinisht, greqisht, turqisht, italisht etj.), si dhe ndikimin e këtyre gjuhëve në leksikun e shqipes janë kryer studime të shumta nga gjuhëtarë shqiptarë dhe të huaj.

⁵ Çabej E. *Studime gjuhësore II*. Rilindja, Prishtinë, 1986.

2.1 Huazime nga italishtja

Çabej i ka dhënë rëndësi dallimit të leksikut që ka hyrë në periudhën e në formën latine nga ajo që ka hyrë më vonë prej gjuhësh që janë vazhdim i latinishtes, ku “në rend të parë vjen italishtja si vijim i drejtpërdrejtë i latinishtes së Gadishullit Apenin, me të cilin brigjet lindore të Adriatikut kanë pasur gjithherë lidhje të ngushta”.⁶

Marrëdhëniet mes shqipes dhe italishtes janë rreth 10-shekullore, për këtë arsye huazimet nga italishtja janë edhe më të shumta në numër.

Studiuesja Kristina Jorgaqi, e cila ka trajtuar në disa punime të saj italianizmat, thekson faktin se “pjesa më e madhe (60 %) e huazimeve italiane në shqipe i është nënshtruar rregullsisë së përgjithshme që ndjekin [...] huazimet në shumë gjuhë të tjera - NGUSHTIMIT të strukturës kuptimore të tyre (në rastet kur modelet paraqiten si njësi polisemantike).⁷ Ndër fjalët që në gjuhën shqipe janë terma të fushave të caktuara, studiuesja Jorgaqi përmend termat: *abort, agjitacion, dirigjoj, divizion, emetoj, divorc, filetoj, fortifikoj, kadet, kuartet, kufje, kurë, kushinetë, libret, obligacion, ofertë* etj.

Ka italianizma të cilat janë riprodhuar në shqipe me një strukturë kuptimore më të rrudhur në krahasim me modelet, si: *garë* (rivalitet), *kapanon* (ngrehinë që përdoret si magazinë), *merkatë* (tip tregu) etj.⁸

⁶ Çabej E. *Studime gjuhësore II*. Rilindja, Prishtinë, 1986.

⁷ Jorgaqi, K. Mbi integrimin leksiko-semantik të italianizmave në shqipen standarde. *Studime filologjike*, Nr.1-2, f.86, Tiranë, 1998.

⁸ Po aty.

Ka dhe huazime italiane që në gjuhën shqipe kanë zgjeruar kuptimin e tyre në përgjithësi ose njërin nga kuptimet e tyre, si: *letër, motor, patriot, amaretë, timon, xhakëtë* etj.

Studiuesja Kristina Jorgaqi ka trajtuar gjerësisht huazimet nga italishtja në gjuhën shqipe, duke u ndalur në faktin që ka dhe një sinonimi pak a shumë të plotë mes huazimeve italiane dhe njësive leksikore të shqipes.⁹ Sipas Jorgaqit, “në literaturën teorike që trajton këtë problem, shprehet mendimi se një situatë e tillë nuk është aspak tipike për raportet mes huazimeve dhe njësive të tjera të sistemit të gjuhës marrëse. Madje, sipas autorëve të cituar më lart, raportet në fjalë janë raporte konkurruese, raporte konflikti, çka e përjashton mundësinë e ekzistencës së lidhjeve sinonimike pak a shumë të plota mes tyre, qoftë edhe për një periudhë të shkurtër. Pas mendimit tonë, raporte të tilla s’ka dyshim se ekzistojnë, madje ato janë një nevojë e brendshme e gjuhës për pasurim të mjeteve shprehëse, një formë e së cilës është pikërisht edhe larmia e njësive sinonimike.”

Ndër këto italianizma që kanë një sinonimi pak a shumë të plotë me njësi leksikore të tjera të sistemit të shqipes, studiuesja Jorgaqi rendit:

abandonoj (braktis), *ambient* (mjedis), *aplikoj* (zbatoj), *aprovoj* (miratoj), *autokton* (vendas), *arbitër* (gjyqtar), *avari* (defekt), *barceletë* (anekdotë), *barkë* (varkë), *çertifikatë* (vërtetim), *dedikoj* (kushtoj), *densitet* (denduri), *devocion* (përkushtim), *dimension* (përmasë), *fantazi*

⁹ Jorgaqi, K. Mbi integrimin leksiko-semantik të italianizmave në shqipen standarde. *Studime filologjike*, Nr.1-2, f.3, Tiranë, 1998.

(imagjinatë), *fenomen* (dukuri), *formë* (trajtë), *funebër* (i përmotshëm), *gusto* (shije), *influcencë* (ndikim), *kapriçio* (tekë), *kapriçoz* (tekanjosh), *kënd* (cep), *kontribut* (ndihmesë), *komunitet* (bashkësi), *konventë* (marrëveshje), *komunitet* (bashkësi), *koordinoj* (bashkërendoj), *mentalitet* (mendësi), *kuadrat* (katror), *kualitet* (cilësi), *legjislacion* (ligjshmëri), *legjitim* (i ligjshëm), *mentalitet* (mendësi), *moment* (çast), *neutral* (asnjanës), *nocion* (koncept), *ofendoj* (fyej), *pasagjer* (udhëtar), *penetroj* (depërtoj), *portofol* (kuletë), *prenotoj* (rezervoj), *proporcion* (përpjesëtim), *i singjertë* (i çiltër), *tavolinë* (tryezë), *vigjilje* (prag) etj.

Sigurisht që pas më shumë se një çerek shekulli, me ndikimin gjithnjë e më të madh të gjuhës angleze, situata e huazimeve nga gjuha italiane ka pësuar ndryshime. Analiza e shembujve të marrë nga faqet e internetit të mediave të analizuara, trajton shkallën e ndryshme të integritetit në shqipen e sotme të fjalëve të ndryshme të huazuara nga italishtja.

Për të pasur një panoramë më të qartë të përdorimit të disa prej italianizmave më të zakonshme në gjuhën shqipe, në këtë studim është analizuar nga ana statistikore frekuencën e përdorimit të disa prej fjalëve të renditura më sipër në disa nga mediat kryesore.

2.2. Frekuenca e përdorimit të italianizmave në media

Ky studim është një analizë statistikore e përdorimeve të italianizmave dhe e fjalëve gjegjëse të tyre në gjuhën

shqipe, të burimit autokton. Nga lista e mësipërme e huazimeve nga gjuha italiane, janë përzgjedhur ato fjalë të cilat kanë një sinonimi më të plotë me fjalë të shqipes. Duhet të theksohet se një pjesë e fjalëve në kllapa mund të jenë edhe huazime që janë futur në gjuhën shqipe në periudha shumë të hershme dhe që sot janë bërë pjesë e leksikut të shqipes.

abandonoj (braktis), *ambient* (mjedis), *aprovoj* (miratoj), *autokton* (vendas), *barkë* (varkë), *dedikoj* (kushtoj), *devocion* (përkushtim), *fenomen* (dukuri), *influcencë* (ndikim), *koordinoj* (bashkërendoj), *kualitet* (cilësi), *mentalitet* (mendësi), *ofendoj* (fyej), *pasagjer* (udhëtar), *tavolinë* (tryezë)

Përdorimi i italianizmave dhe i fjalëve gjegjëse të shqipes është monitoruar në lajmet e faqeve *balkanweb.com*, *tvklan.al*, *euronews.al*, *panorama.com.al*, në një shtrirje kohore disavjeçare.

Sikurse u theksua më lart, periudha kohore e monitorimit për secilën media është e ndryshme, në periudhën kohore që mundëson arkivi i secilës media. Data e fundit e monitorimit për të katër mediat është data 25 shkurt 2025.

Është e rëndësishme që të sqarojmë se të dhënat e paraqitura në tabelat e mëposhtme nuk janë dhënë për të krahasuar mediat e ndryshme me njëra-tjetrën për të përcaktuar se cila është media që përdor më shumë fjalë të huaja, pasi sikurse u theksua dhe më lart statistikatat tregojnë të dhëna për periudha të ndryshme për secilën media dhe një krahasim i tillë është i pamundur të bëhet.

Synimi i vetëm i këtij studimi është për të kuptuar gjendjen reale të përdorimit të fjalëve të huaja, për të kuptuar prirjen e përdorimit të fjalëve dhe cili është vendi që kanë këto italianizma në leksikun e shqipes sot.

➤ *abandonoj-braktis*

Në Fjalorin e Shqipes¹⁰ jepet përkufizimi i mëposhtëm për fjalën *braktis*.

1. *Largohem prej një vendi, e lë përgjithnjë a për një kohë të gjatë; largohem prej dikujt, e lë vetëm. Braktisën vendin.*

2. *Heq dorë nga diçka përgjithnjë a për një kohë, nuk merrem më me të; lë punën ose një veprimtari. Braktisi mësimet.*

3. *Lë pas dore, nuk kujdesem më; e lë pa ndihmë e pa përkrahje, i kthej krahët. Braktisi tokën.*

Folja *abandonoj* nuk është përfshirë në Fjalorin e Shqipes.

Çabej e konsideron foljen *braktis* huazim nga turqishtja *brakti*, preteriti i foljes *brakmak*, me kuptimin “lë, lëshoj dore, heq dorë prej saj.” Kjo folje ka hyrë nga turqishtja dhe në gjuhë të tjera ballkanike dhe është fjalë e mbarë shqipes dhe prej shqipes ka kaluar dhe në arumanisht. Nga folja *braktis* me anë të prapashtesimit është formuar në shqip emri *braktisje*.¹¹

¹⁰ *Fjalori i gjuhës shqipe*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë, 2020.

¹¹ Çabej E. *Studime etimologjike në fushë të shqipes*. Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Tiranë, 1976, f.300.

Në Tabelën 1 janë paraqitur të dhënat e monitorimit për frekuencën e përdorimit të foljeve *abandonoj* dhe *braktis* në vetën e tretë të kohës së tashme dhe të së kryerës së thjeshtë të dëftores; të emrave *abandonim* dhe *braktisje* në trajtat e lakimit të tyre në njëjës dhe në shumës, në mediat e monitoruara në këtë studim.

Të dhënat tregojnë qartazi se, folja *abandonoj*, në vetën e tretë të së tashmes dhe të së kryerës së thjeshtë të dëftores, në pjesore, si dhe emri *abandonim*, në të gjitha format rasore kanë një përdorim fare të ulët sot. Mund të thuhet se këto fjalë janë zëvendësuar pothuajse plotësisht me foljen *braktis* dhe emrin *braktisje*. Pra, *braktis*, një huazim i vjetër, duket se është bërë pjesë e plotë e leksikut të shqipes dhe parapëlqehet ndaj italianizms *abandonoj* dhe formimit të shqipes, prej saj, *abandonim*.

Tabela 1. Numri i përdorimit të fjalëve: *abandonoj* ↔ *braktis*

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
abandonon	0	0	4	10
abandonoi	0	0	8	1
abandonohet	0	0	2	0
abandonohen	0	0	2	0
abandonuar	6	5	66	21
abandonimi	4	0	17	6
abandonim	1	1	3	1
abandonimin	1	0	7	1
abandonime	0	0	0	0
abandonimeve	1	0	0	0
Braktis	902	1952	3430	1042
braktisi	1120	548	2860	729
braktiset	62	47	437	94

braktisen	513	136	1320	73
braktisur	5490	751	6800	2389
braktisje	106	207	508	167
braktisja	312	82	883	225
braktisjen	291	95	794	235
braktisjes	188	83	597	214
braktisjet	3	1	8	3
braktisjeve	0	0	4	7

Dihet se gazetarët përdorin format veprorë në përshkrimin e veprimeve dhe ngjarjeve, ndërsa ata preferojnë pësoren në paraqitjen e veprimeve në të cilat vepruesi/subjekti është i panjohur ose i parëndësishëm. Nga të dhënat e Tabelës 1 rezulton se ka një përdorim më të madh të foljes *braktis* në formën veprorë.

16 korrik 2019 (*balkanweb.com*) E trishtë, nëna braktis fëmijët, e bija përplaslet live me tezen.

17 korrik 2026 (*panorama.com.al*) Fëmija braktiset nga nëna 18-vjeçare.

Në Tabelën 2 janë paraqitur të dhënat e detajuara për statistikat e përdorimit të pjesores *braktisur* ku vihet re një përdorim i lartë i kësaj forme foljore.

Tabela 2. Numri i përdorimit të pjesores *braktisur*

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
braktisur	5490	751	6800	2389

Numri i lartë i përdorimit të formës së pjesores *braktisur* ka të bëjë me përdorimin e saj jo vetëm në trajtat e së kryerës dhe mëse të kryerës së dëftores, por dhe në format e pashtjelluara dhe në trajtat e mbiemrave të formuar prej pjesores:

10 shkurt 2025 (TV Klan) Deri më tani, raportohet se 10 mijë rezidentë e turistë kanë braktisur Ishullin.

8 qershor 2024 (Euronews) Vajza e kishte braktisur shkollën.

17 dhjetor 2024 (Balkanweb) Madje nuk ishte as i pranishëm në ceremoni, duke e braktisur së bashku me klubin e Realit

11 dhjetor 2024 (Panorama) Brenda shtëpisë së braktisur të Bashar Al-Assadit.

Në një analizë statistikore më të thelluar që lidhet me karakteristikat e teksteve të lajmeve,

vihet re një përdorim më i madh i foljes *braktis* në të gjitha trajtat, krahasuar me përdorimin e emrit *braktisje*. Përdorimi i foljes tregon se gazetarët kanë pasur në fokus veprimin që tregon folja.

Tabela 3. Numri i përdorimit të fjalëve: *braktis* ↔ *braktisje*

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
<i>braktis</i> (në të gjitha trajtat)	8087	3434	14847	4327
<i>braktisje</i> (në të gjitha trajtat)	900	468	2794	851

➤ *ambient-mjedis*

Fjala *mjedis* është fjalë e mbarë gjuhës shqipe, e përdorur më shumë në gegërishte, por e përgjithësuar sot me kuptimin “ambient”. Konsiderohet si formim i brendshëm i shqipes nga togu parafjalor *mjet visi* (mes vendi) dhe është e dokumentuar që në veprën e Buzukut.¹²

¹² Çabej E. *Studime etimologjike në fushë të shqipes* V. Botime Çabej, Tiranë, 2014, f.343.

Në Fjalorin e Shqipes, për fjalën *mjedis*¹³ jepet përkufizimi i mëposhtëm:

1. *Tërësia e kushteve natyrore, në të cilat jeton e zhvillohet njeriu a një qenie tjetër, ndodhet e ndryshon një send, zhvillohet një dukuri etj.; gjithçka që rrethon një organizëm dhe ndikon mbi të; hapësira a sendet që na rrethojnë; ambient. Mjedisi rrethues.*
2. *Kushtet shoqërore dhe të jetës, në të cilat rron e vepron njeriu; grup njerëzish të një profesioni etj. a me kushte të tilla të përbashkëta, në gji të të cilit rron e punon dikush; ambient. Mjedisi shqiptar. Mjedisi arbëresh. Mjedisi punëtorësh. Mjedisi shoqëror.*

Ndërsa fjala *ambient* përkufizohet si më poshtë:

1. *Tërësia e kushteve natyrore, në të cilat jeton e zhvillohet njeriu ose një qenie tjetër; gjithçka që rrethon një send a një organizëm dhe që ndikon mbi të; mjedis. Ambienti gjeografik (natyror).*
2. *Kushtet shoqërore, në të cilat rron e vepron njeriu; grup njerëzish me një profesion a me kushte jetësore të përbashkëta, në gji të të cilit rron e punon njeriu; mjedis. Ambienti shoqëror.*
3. *Dhomë a pjesë e një ndërtese ose hapësira rreth saj, që shërben për një punë a veprimtari. Ambientet ndihmëse (mësimore, shkollore).*
4. *fig. Kushtet, rrethanat që ndikojnë për një gjendje shpirtërore të njeriut. Ambient i ngrohtë (i ftohtë). 5. spec. Lëndë që mbush një hapësirë dhe që me vetitë e saj ndikon mbi një trup; mjedis. Ambient tokësor (ajror). Ambient ushqyes.*

¹³ *Fjalori i gjuhës shqipe.* Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë, 2020.

Përkufizimet e fjalëve *mjedis* dhe *ambient* janë të njëjta përsa u përket kuptimeve 1 dhe 2 të fjalës *ambient*. Shpesh këto fjalë përdoren si sinonime të plota brenda të njëjtit tekst, për të shmangur përsëritjen e së njëjtës fjalë.

24 janar 2017 (panorama.com.al) Studentët mbështesin kauzën për një mjedis të pastër.

24 janar 2017 (panorama.com.al) Ndotja e ambientit është një sëmundje e pashërueshme.

Fjala *ambient* ka dhe një kuptim të tretë që lidhet me “dhomën a pjesën e një ndërtese ...”.

Gjatë viteve të fundit, vihet re një përdorim gjithnjë e më i dendur i fjalës *ambient*, pikërisht për t’iu referuar “Dhomës a pjesës së një ndërtese ose hapësira rreth saj, që shërben për një punë a veprimtari.”

Në ditët e sotme, në njoftimet e ndryshme për pronat hasen dendur termat: *ambient biznesi me qira; ambient tregtar, ambient komercial, ambient për zyrë, ambient zyre, ambient biznesi, ambient në shitje* etj.

Pikërisht ky kuptim i tretë i fjalës *ambient*, mund të shpjegojë numrin më të madh të përdorimit të fjalës *ambient* në të katër mediat e analizuara, sikurse shihet në Tabelën 4.

Tabela 4. Numri i përdorimit të fjalëve: *ambient* ↔ *mjedis*

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
ambienti	905	537	2770	634
ambient	2840	4772	5890	1768
ambientin	1580	221	4520	906
ambientit	524	166	1480	549
ambiente	2350	3655	3690	2053
ambientet	9060	2619	16600	5839

ambienteve	1870	608	3400	1404
ambientesh	18	4	77	21
mjedis	2410	2713	3300	1407
mjedisi	1350	1457	1800	690
mjedisin	2160	418	2920	1065
mjedisit	4280	962	4610	2740
mjedise	647	659	1080	509
mjediset	1360	427	2260	879
mjediseve	122	104	488	222
mjedisesh	3	2	11	5

Në tabelën 5 është paraqitur numri i përgjithshëm i përdorimit të këtyre fjalëve, bazuar në të dhënat më të detajuara të Tabelës 4. Shihet se përdorimi i fjalës *ambient* është pothuaj dy herë më i madh nga përdorimi i fjalës *mjedis*.

Tabela 5. Numri i përdorimit të fjalëve: *ambient* ↔ *mjedis*

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
<i>ambient</i> (në të gjitha trajtat)	19147	12582	38427	13174
<i>mjedis</i> (në të gjitha trajtat)	12332	6742	16469	7517

Rastet më të shpeshta të përdorimit të fjalës *ambient*, janë në numrin shumë, në trajtën e shquar dhe të pashquar (*ambiente/ambientet*).

Tabela 6. Numri i përdorimit të fjalëve: *ambiente* ↔ *ambientet*

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
<i>ambiente</i>	2840	4772	5890	1768
<i>ambientet</i>	9060	2619	16600	5839

Nga shembujt e analizuar, rezulton një përdorim i fjalëve *ambiente*, *ambientet* në të gjitha kuptimet e tyre, por në shumë raste në kuptimin e saj si një hapësirë që shërben për punë a për një veprimtari.

4 shkurt 2025 (Euronews) U gjet pa shenja jete në ambientet e teqesë.

5 dhjetor 2021 (Panorama) I kishin kthyer lokalet në ambiente për lojërat e fatit.

6 dhjetor 2024 (Balkanweb) Festat e fundvitit, ndizen dritat festive në ambientet e Presidencës.

7 janar 2025 (Tvklan) Projekti është ideuar si një hapësirë multidimensionale ku krahas zyrave do të ketë edhe ambiente të dedikuara për parkim.

Ndër trajtat e emrit *mjedis* në numrin njëjës, forma më e përdorur Përdorimi më i shpeshtë i trajtës rasore *mjedisit*, mendojmë se lidhet kryesisht me informacionet për Ministrinë e Mjedisit:

Tabela 7. Numri i përdorimit të fjalës: *ambientit*

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
mjedisit	4280	962	4610	2740

8 korrik 2019 (Panorama) Akuzat për ndotje, Ministria e Mjedisit: TITAN, sipas standardeve europiane.

13 shkurt 2025 (Balkanweb) Përgjegjëse për pastrimin është Ministria e Mjedisit.

27 korrik 2024 (TV Klan) Vlora nën pushtetin e tymit,
Ministria e Mjedisit mban peng operimin e
landfillit të Sherishtës.

24 gusht 2024 (Euronews) ‘Mbetjet’ Ministria e
Infrastrukturës dhe ajo e Mjedisit me
deklaratë të përbashkët.

➤ *aprovoj-miratoj*

Fjala “mirë” është fjalë e mbarë shqipes me burim të trashëguar. Lidhet me rrënjën ie. *mei-r, mi-r “i butë, i ëmbël”*. Është dëshmuar që në Fjalorthin e Arnold von Harfit.¹⁴ Folja *miratoj* është formim i brendshëm i shqipes me prapashtesa.

Sipas Fjalorit të Shqipes, përkufizimi i fjalës *miratoj* është:

1. *E pranoj diçka zyrtarisht si të drejtë, të rregullt, të lejueshme etj.; e pranoj një gjë si të vendosur përfundimisht, shpreh pëlqim të plotë për diçka. Miratuan planin (vendimin, ligjin, projektin).*
2. *Pëlqej një veprim a një sjellje dhe shpreh përkrahjen për të, e pranoj diçka si të mirë; pajtohem me diçka dhe e quaj të drejtë. Ia miratoi mendimin (fjalët). E miratoi plotësisht (me gjithë zemër).*

Folja *aprovoj* është konsideruar si një folje e ligjërimit libror, sinonim me foljen *miratoj*.

aprov/ój shih MIRATOJ. Aprovoi një vendim (një ligj). Aprovoi projektin (statutin, rregulloren...).

¹⁴ Topalli K. *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*. Akademia e Studimeve. Albanologjike, Tiranë, 2017.

Në Tabelën 8 janë paraqitur të dhënat numerike të përdorimit të foljeve *aprov* dhe *mirat* në vetën e tretë të njëjësit dhe të shumës, të formave veprare dhe joveprare, të pjesores, si dhe rastet e përdorimit të emrave *aprovim* dhe *miratim* në trajtat e njëjësit dhe të shumës.

Tabela 8. Numri i përdorimit të fjalëve: *aprov* ↔ *mirat*

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
aprovon	12	62	176	100
aprovohet	31100	72	222	130
aprovohen	45	25	66	35
aprovoi	155	72	220	128
aprovuan	53	21	86	41
aprovuar	770	292	1070	498
aprovim	153	252	235	92
aprovimi	180	213	221	145
aprovimin	446	123	933	403
aprovimit	130	47	172	84
aprovime	9	6	16	4
aprovimet	13	5	10	6
miraton	3920	1401	3550	1392
miratohet	3140	943	4680	2024
miratohen	1210	279	1590	623
miratoi	3990	1149	4890	2313
miratuan	1230	308	1390	617
miratuar	14500	3074	14300	6299
miratim	1440	2490	2150	976
miratimi	2630	2224	3660	1480
miratimin	6320	1313	8910	3367
miratimit	2790	514	3420	1471
miratime	56	17	50	25
miratimet	45	9	40	19

Duke u bazuar te numri i përgjithshëm i përdorimeve të këtyre fjalëve, mund të thuhet se ka një parapëlqim më të madh për foljen *miratoj* në tri nga katër mediat e marra në monitorim.

Tabela 9. Numri i përdorimit të fjalëve: *aprovoj* ↔ *miratoj*

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
<i>aprovoj</i> (në të gjitha trajtat)	32135	544	1840	932
<i>miratoj</i> (në të gjitha trajtat)	27790	7154	30400	13268

Numri i lartë i përdorimit të foljes *aprovoj* në vetën e tretë të së tashmes së pësorës *aprovohet* (31100), në faqen balkanweb.com, shpjegohet me fjalinë standarde që vendoset në fund të lajmeve të kësaj faqeje: *Për t’u bërë pjesë e grupit “Balkanweb” mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t’ju aprovohet menjëherë.*

Një përdorim më i madh i foljes *aprovoj/aprovohet* në fjalinë e mësipërme, mund të jetë si rezultat i ndikimit të strukturave të gjuhës angleze në aplikacionet e ndryshme dhe në faqet e internetit: *to approve a request*¹⁵, *to be approved*. Folja *to approve* (*aprovoj*) në anglisht është një huazim nga frëngjishtja.

Ndonëse në raste jo të shpeshta, ka një prirje të përdorimit të të dyja foljeve *aprovoj* dhe *miratoj* brenda të njëjtit lajm, gjë që me sa duket ndodh edhe për të shmangur përdorimin e shpeshtë të së njëjtës fjalë, duke i trajtuar si fjalë sinonimike të plota.

¹⁵ [Auto approve a join request | Microsoft Community Hub.](#)

29 janar 2021 (euronews.al) Hungaria aprovon vaksinën kineze, vendi i parë në BE që miraton përdorimin e vaksinës 'Sinopharm'.

Rastet e përdorimit të të dyja foljeve brenda të njëjtit tekst duhen shmangur, pasi janë fjalë sinonimike. Përdorime të tilla hasen më shumë në intervista.

27 tetor 2023 (panorama.com.al) Vendimtar do të jetë trajneri Zyber Konçi, që spikat talentin dhe miraton, aprovon konkurrimin e tij.

Në analizën statistikore janë përfshirë dhe të dhënat për përdorimin e pjesoreve *aprovuar* dhe *miratuar*.

Numri i lartë i përdorimit të tyre, në veçanti i pjesores *miratuar*, lidhet me përdorimin e saj në trajtat analitike të së kryerës, mëse të kryerës, te mbiemrat prejfoljorë dhe në format e pashtjelluara.

Tabela 10. Numri i përdorimit të fjalëve: *miratuar* ⇔ *aprovuar*

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
<i>miratuar</i>	14500	3074	14300	6299
<i>aprovuar</i>	770	292	1070	498

Në motorin e kërkimit të faqes Balkanweb, ishte i mundur një kërkim më i detajuar i përdorimit të pjesores, dhe sipas këtij kërkimi rezultoi se 9960 përdorime të pjesores janë në trajtat analitike të së kryerës *është miratuar*. Këto trajta janë përdorur kryesisht në lajmet për institucionet e ndryshme të pushtetit qendror dhe lokal:

2 shtator 2018. Ligji është miratuar të enjten në parlament.

17 janar 2019 Është miratuar Vendimi nr. 782, datë. 26.12.2018 i Këshillit të Ministrave.

8 tetor 2018 Drafti i ndryshimeve është miratuar me 108 vota pro.

24 nëntor 2014 Duke qenë se projekti i rehabilitimit të sheshit është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

Parapëlqimi për fjalët e shqipes në vend të fjalës së huaj është i dukshëm dhe në përdorimin e emrave *miratim* dhe *aprovim* në të gjitha rastet.

Tabela 11. Numri i përdorimit të fjalëve: *miratim* ↔ *aprovim*

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
<i>miratim</i> (në të gjitha trajtat)	13281	6567	18230	7338
<i>aprovim</i> (në të gjitha trajtat)	931	646	1587	734

10 qershor 2024 (*balkanweb.com*) Himni shtetëror i Kosovës sot mbush 16 vjet nga miratimi në Kuvendin e Kosovës.

23 nëntor 2013 (*panorama.com.al*)
Westerwelle: Miratimi i 3 ligjeve, i domosdoshëm

18 gusht 2024 (*tvklan.tv*) Miratimi i ligjit të sponsorizimeve është një kërkesë jetike për futbollin.

21 janar 2025 (*euronews.al*) Në rend dite ishte diskutimi dhe miratimi i buxhetit të vitit 2025.

Përdorimi pak më i lartë i trajtës së kallëzores së shquar *miratimin* është tregues i përdorimit më të lartë të foljeve në mënyrën veprorë, por dhe i

lajmeve për vendimet e Këshillit të Ministrave, të cilat karakterizohen nga struktura të tipit: *Vendim për miratimin...*

17 shkurt 2024 (balkanweb.com) Minatorët e tubuar në qendër të qytetit kërkuar miratimin e statusit, një premtim ky i dhënë nga të gjitha kahet politike.

20 qershor 2024 (panorama.com.al) Sot zbardhet i plotë vendimi "Për miratimin e kuotave të përgjithshme të kredive të reja për kategoritë prioritare të të punësuarve përfitues në administratën publike e Këshillit të Ministrave".

Studime të tjera më të thelluara veçanërisht në faqen e Kuvendit të Shqipërisë, të Kryeministrit dhe institucioneve të tjera shtetërore do të japin një panoramë më të qartë në lidhje me prirjen e sotme për përdorimin e foljeve *miratoj*, *aprovoj* në të gjitha trajtat e tyre, si dhe emrat përkatës *miratim*, *aprovim*, duke qenë se janë ndër fjalët më të përdorura të leksikut parlamentar dhe administrativ.

autokton-vendas

Fjala *vend*, fjalë e mbarë gjuhës, është e trashëguar nga fondi indoevropian. Lidhet me rrënjën ued "tokë, truall. Përbrenda shqipes lidhet me foljen *vë/vê* (Meyer)/. Dëshmohej së pari te Buzuku.¹⁶

Nga fjala *vend* janë formuar fjalët *vendës* dhe *vendas* që përdoren si variante të së njëjtës fjalë. Këto fjalë përdoren si emra dhe si mbiemra.

¹⁶ Topalli K. *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*. Akademia e Studimeve. Albanologjike, Tiranë, 2017.

Në Fjalorin e Shqipes jepen këto përkufizime për fjalën *vendës/vendas*.¹⁷

VENDËS *m.*

1. Banor i një vendi, që ka lindur e është rritur aty, banor që bën pjesë në një familje, e cila nuk ka ardhur nga një vend tjetër; secili ndër banorët më të parë a më të vjetër të një vendi, që kanë jetuar aty brez pas brezi; anas, rrënjës; kund. ardhës. Vendësit dhe të ardhurit. Trojet e vendësve. 2. Ai që jeton e punon prej kohësh në një vend, banor i një fshati, i një qyteti, i një krahine a i një shteti të caktuar. Vendësit shtruan një darkë. Fituan vendësit.

VENDËS *mb.*

1. Që ka lindur e është rritur në një vend të caktuar dhe nuk ka ardhur nga një vend tjetër, që ka jetuar brez pas brezi në një vend të caktuar; që është krijuar në një vend të caktuar; i vendit; kund. i ardhur. Banor vendës. Popullsia vendëse. Mësuese (mjeke) vendëse. Zakone (valle) vendëse. 2. Që jeton e punon prej kohësh në një vend të caktuar; që ka të bëjë me një vend të caktuar; që i përket këtij vendi, i vendit. Futbollistët (artistët) vendës. Autor vendës.

Fjala *autokton* përdoret, po ashtu, si emër dhe si mbiemër. Përkufizimet për fjalën *autokton* janë të njëjta me ato të fjalës *vendës/vendas*.

AUTOKTON *m. libr.*

Pjesëtar i popullsisë fillestare të një vendi; banor i një vendi ku kanë jetuar paraardhësit e tij që në kohët më të lashta; vendës, anas, rrënjës.

¹⁷ *Fjalori i gjuhës shqipe*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë, 2020.

AUTOKTON mb. libr.

1. Që është rrënjës në një vend; që banon në atë vend ku kanë jetuar paraardhësit e tij që në kohë më të lashta; vendës, anas. Popullsi autoktone. Banorët autoktonë.
2. Që është i atij vendi, që nuk është i ardhur; që është krijuar aty ku ndodhet sot. Bimë autoktone. Tokë autoktone.


Të dhënat e paraqitura në Tabelën 13 tregojnë qartë se fjalët *vendës/vendas* kanë një numër përdorimi shumë herë më të madh nga fjala *autokton*.

Tabela 13. Numri i përdorimit të fjalëve: *autokton-vendës (vendas)*

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
Autokton	166	78	136	58
Autoktonë	67	60	389	50
Autoktonët	30800	0	8	1
Vendas	5000	2524	6460	3414
Vendase	4270	971	5860	3285
Vendasit	2130	309	4780	1311
Vendës	88	6040	5280	22
Vendësit	12	188	5430	1

Ndërsa numri i lartë i përdorimit të emrit *autoktonët* në faqen *balkanweb.com*, shpjegohet me titullin e emisionit *autoktonët*.

Figura 2. Emisioni *Autoktonët*



EMISIONE NEWS24	KATEGORI
Autoktonët	Filimi
Qeshja e Dites	Minute pas minute
Emisioni Vite 24	Shtatëpërtë
EURO24	Politikë
Tir Station	Krimina
Cezuar me ju	Kosova
Kjo Javë	Rajoni
Koha për t'u zgjuar	Sport
Me zemër të hapur	Bota
NE shënjëtor	Kulturë
Open	Metropol
Podcast	Analiza
Shtete	Teknologji
Sport News	Shëndeti
Tak Fik	Horoskopi
Netting	Emisione

Numri shumë i vogël i përdorimit të fjalës *autokton* dëshmon se fjala *autokton* përdoret kryesisht si mbiemër, ndërsa *vendas/vendës* përdoret në të dyja kategoritë gramatikore.

28 nëntor 2022 (euronews.al) Kritikë në rrjet për flamurin "autokton"

20 gusht 2020 (panorama.com.al) Monedha e gjelbër ka shënuar një rënie të fortë ditët e fundit në tregun vendas.

2 dhjetor 2018 (panorama.com.al) Vendasit kanë arritur të fitojnë me rezultatin 1-0 me anë të një goli spektakolar.

Vendas dhe *vendës* përdoren dhe brenda të njëjtit tekst, duke u konsideruar në këtë mënyrë si fjalë sinonimike apo variante të së njëjtës fjalë.

7 korrik 2017 (panorama.com.al) Mbase duke ditur prirjet e tifozëve vendas, policia bullgare nuk lejoi tifozët e Partizanit.

7 korrik 2017 (panorama.com.al) Gjatë ndeshjes thirrjet e tifozëve vendës ishin shumë të rënda.

➤ *barkë-varkë*

Çabej i konsideron të dyja këto fjalë si huazime: *barkë* prej italishtes *barca* dhe *varkë* prej greqishtes së re.¹⁸ Fjala *barkë* del që te Buzuku. Këto dy fjalë dallojnë nga ana kuptimore vetëm në rastin e përdorimit të fjalës *barkë* në kuptimin teknik si pjesë e makinave të larjes ose të ngjyrosjes së rrobave.

BARKË f.

1. Mjet i thjeshtë lundrimi, më i vogël se anija, që vihet në lëvizje me lopata, me vela ose me motor; *varkë*. *Barkë dërrase (gome)*. *Barkë me lopata (me rrema, me vela, me motor)*.

Barkë peshkimi. *Barka e shpëtimit*. *Bashi i barkës*. *Lundroj (shëtiti) me barkë*. *Ngas barkën*.

2. tek. Pjesë e makinave të larjes ose të ngjyrosjes së rrobave etj. që është si govatë.

* *Ka hipur në barkë pa vela ecën me drejtim të pacaktuar, ecën kuturu në jetë*.

VARKË f.

Barkë. *Varkë dërrase (gome)*. *Varkë peshkimi*. *Varkë me motor*. *Lundron (shëtiti) me varkë*.

Në kërkimin për të dhënat statistikore për fjalën *barkë* është shmangur trajta e shquar e së tashmes/forma e pashquar e shumësit, pasi të dhënat e kërkimit përfshinin raste të përdorimit të fjalës *barka* si mbiemër

¹⁸ Çabej. E. *Studime etimologjike në fushë të shqipes*. Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë. Tiranë, 1976, f.169.

(deputeti Barka). Të dhënat e tabelës 14 tregojnë parapëlqimin për fjalën *varkë* në tekstet e lajmeve.

Tabela 14. Numri i përdorimit të fjalëve: barkë-varkë

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
barkë	229	42	178	60
barkat	4	7	46	34
varkë	1030	314	1080	432
varka	1130	429	1010	556
varkat	35	112	196	140

Ka një sinonimi të plotë mes këtyre fjalëve dhe për këtë arsye gjenden të përdorura në të njëjtin tekst.

28 shtator 2023 (balkanweb.com) Kur i nxora me varkë pranë kampit të punëtorëve, ata më thanë t'u tregoja rrugën.

28 shtator 2023 (balkanweb.com) Më tha të merrnin barkën dhe të shkonim në Dajlan.

➤ *devocion -përkushtim*

Fjala *përkushtim* është e formuar nga folja *kushtoj*. Fjalët *kusht*, *kushtoj* janë konsideruar si huazime më të vjetra, të huazura prej latinishtes.¹⁹

Sipas Fjalorit të Shqipes, fjala *devocion* ka kuptimin:

1. Ndjenjë e pastër dhe e zjarhtë nderimi, dashurie e besnikërie që ushqejmë ndaj dikujt a diçkaje, gatishmëri për të bërë gjithçka për të. Devocion i thellë (i madh, i pakufishëm). Punon (shërben) me devocion.

¹⁹ Çabej. E. *Studime etimologjike në fushë të shqipes* V. Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë. Tiranë, 1976, f.169.

2. Ndjenja e besimit të pakufishëm te dogma e një feje a te një kult dhe përulja e thellë ndaj tyre (në vendet ku vepron feja). Lutej me devocion.

Fjala *përkushtim* është dhënë si një sinonim me fjalën *kushtim*.

1. kushtím,-i emër i gjinisë mashkullore; numri shumë; -e(t) 1. veprimi sipas foljeve.

2. shkrim i shkurtër mbi një vepër, që tregon se cilit a cilës i kushtohet ajo; përkushtim.

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në Tabelën 15 shihet qartë se fjala *devocion*, e huazuar nga italishtja, përdoret në shifra gati të papërfillshme në krahasim me fjalën *përkushtim*, që tregon se prirja është drejt përdorimit të fjalës *përkushtim*, e formuar me mjete te shqipes, nga një huazim latin, një fjalë që është bërë pjesë e leksikut të shqipes në periudha shumë të hershme.

Tabela 15. Numri i përdorimit të fjalëve: *devocion* ↔ *përkushtim*

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
devocion	13	8	130	18
devocioni	2	6	30	3
devocionin	6	4	39	0
devocione	6	0	40	0
devocionet	0	0	0	1
devocionit	1	2	14	5
përkushtim	2380	1067	4490	1212
përkushtimi	788	756	1620	488
përkushtimin	2170	496	3020	1119
përkushtimit	450	120	1010	337
përkushtime	1	11	15	6
përkushtimet	3	8	43	17

Të dhënat e Tabelës 15 tregojnë një përdorim pak më të madh të trajtave të fjalës *përkushtim* në të pashquarën e emërores dhe në kallëzore, gjë që është e pritshme, pasi përdorimet më të zakonshme të fjalës *përkushtim* janë: *me përkushtim*, *për përkushtimin*.

10 tetor 2024 (balkanweb.com) Njerëzit që lënë punët dhe jetën personale për të ndarë me ne një punë të bërë me përkushtim dhe dashuri.

11 janar 2023 (euronews.al) Do të vazhdojmë punën e angazhimit tonë për Kosovën me përkushtim të plotë.

16 maj 2024 (panorama.com.al) Falënderoj për përkushtimin e tij të palodhshëm për avancimin e vizionit tonë për një Kosovë të sigurt.

18 tetor 2024 (tvklan.tv) Ne ju jemi mirënjohës për përkushtimin dhe dashurinë tuaj ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Ndonëse fjalët *përkushtim* dhe *devocion* konsiderohen si fjalë sinonimike të plota, në monitorimin e medias, janë hasur përdorime të këtyre dy fjalëve brenda së njëjtës fjali, kryesisht në fjalimet e politikanëve apo të personave të tjerë. Kështu, në gazetën *panorama.com.al* janë gjetur 20 raste të përdorimit të këtyre fjalëve në të njëjtin kontekst gjuhësor. Media, këtu, nuk mund të luajë rol, pasi bën pasqyrimin e fjalëve të folësve të ndryshëm.

2 prill 2022 Synonte e realizonte përgatitjen e patriotëve e specialistëve të aftë, që t'i shërbenin atdheut dhe popullit me devocion e përkushtim të madh.

8 shkurt 2015 Shërbeu me devocion dhe përkushtim në kohë të vështira dhe në nevoja të mëdha për qytetarët e Tiranës.

18 gusht 2021 Dhjetë ditë përkushtim, devocion, për të gjithë profetët.

19 prill 2018 Të shumtë janë pacientët e vegjël që janë ndjekur me përkushtim dhe devocion nga stafi i mjekëve.

➤ dedikoj-kushtoj

Fjalët *kusht*, *kushtoj* janë konsideruar si huazime më të vjetra, të huazura prej latinishtes.²⁰

Përkufizimet për foljen *kushtoj* janë si më poshtë:

1. *vë ose jap gjithçka në shërbim të dikujt a të diçkaje; tregoj kujdes të madh për dikë a për diçka; përkushtoj; flijoj: gjithë jetën ia kushtoi atdheut (shkencës).*
2. *hartoj a bëj një vepër në kujtim të dikujt ose në shenjë dashurie a nderimi, duke vënë mbi të një shkrim të shkurtër për këtë gjë: ia kushtoj nënës (mësuesit, bashkëshortes).*

Folja *dedikoj* konsiderohet foljen e ligjërimit libror (i kushtoj).

Në monitorimin e rasteve të përdorimit të foljes *kushtoj* nuk është përfshirë veta e tretë e numrit njëjës dhe të së kryerës së thjeshtë *kushton/kushtoi*, për të shmangur

²⁰ Çabej E. *Studime etimologjike në fushë të shqipes V*. Botime Çabej, Tiranë, 2014, f.184.

përfshirjen e rasteve të përdorimit të kësaj foljeje me kuptimin e mëposhtëm:

KUSHTON *jokal. dhe kal.*

1. Ka një çmim të caktuar kur shitet (për një send a për një mall); vlen, bën. Kushton lirë (shtrenjtë). Kushton pak (shumë). Sa kushton?

2. Kërkon që të harxhohen shumë të holla, të përdoren shumë mjete etj.; vete. Udhëtimi na kushtoi shumë. Dasma i kushtoi shtrenjtë. Shtëpia u kushtoi pak.

3. fig. Do, kërkon; sjell shumë mundime, kërkon përpjekje etj. Na kushtoi shtrenjtë (shumë).

Tabela 16. Numri i përdorimit të fjalëve: *dedikoj* ↔ *kushtoj*

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
dedikon	131	26	2050	158
dedikoi	39	41	846	133
dedikohet	363	116	1440	440
dedikohen	131	21	159	66
dedikuar	2640	581	5180	1697
dedikim	703	63	4980	411
dedikime	140	8	449	37
dedikimet	20	4	368	29
dedikimit	12	4	60	19
dedikimin	109	13	3980	119
kushtohet	670	183	1410	571
kushtohen	20	33	126	42
kushtuar	5390	1629	9880	2894
kushtim	7	1077	31	28
kushtimit	1	9	15	9
kushtimin	0	7	17	0
kushtime	2	0	7	0
kushtimet	0	0	3	0

Për të pasur një krahasim më objektiv mes rasteve të përdorimit të foljeve *dedikoj* dhe *kushtoj*, kemi analizuar kryesisht format *dedikohet*, *dedikohen*, *dedikuar* dhe format gjegjëse *kushtohet*, *kushtohen*, *kushtuar*. Numri i përgjithshëm i përdorimit të këtyre trajtave foljore dëshmon për një parapëlqim më të madh për trajtat e foljes *kushtoj*.

Tabela 17. Numri i përdorimit të fjalëve: *dedikoj kushtoj*

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
<i>Dedikoj</i> (në të gjitha trajtat)	3134	718	6779	2203
<i>Kushtoj</i> (në të gjitha trajtat)	6080	1845	11416	3507

Numri i madh i përdorimit të pjesoreve *kushtuar* dhe *dedikuar* lidhet me përdorimin e tyre në të gjitha format analitike të foljeve, në format e pashtjelluara dhe tek mbiemrat. Shpesh përdoren si forma sinonime brenda të njëjtit tekst, madje edhe brenda një fjalie, ndoshta për të shmangur përsëritjen e së njëjtës fjalë.

30 qershor 2017 (*panorama.com.al*) *Një festival dedikuar filmave dokumentarë mbi artin pamor do të zhvillohet në qytetin e Shkodrës, që së fundi ka tërhequr vëmendjen me aktivitetet kushtuar sidomos kësaj fushe të artit.*

Të dhënat e Tabelës 16 tregojnë dukshëm për një përdorim fare të ulët të trajtave të foljes *kushtim*. Në monitorimin e rasteve të përdorimit të emrave *dedikim* dhe *kushtim* është marrë konsideratë fakti që fjala *kushtim* ka dy kuptime të ndryshme, njëra prej ta cilave lidhet me kuptimin e fjalës *kushton* dhe lidhet me kostot dhe çmimet. Kështu, nga 15 rastet e përdorimit

të trajtës *kushtimit* në faqen panorama.com.al, 8 raste janë në kuptimin sinonimik me fjalën *dedikim* dhe 7 të tjera janë për kostot e lidhura me shpenzimet. Po ashtu, në faqen tvklan.tv, nga 9 raste, vetëm 3 janë sinonime të fjalës *dedikim*. Këto përdorime lidhen dhe me termin e përdorur nga INSTAT-i “Indeksi i kushtimit në ndërtim”.

26 gusht 2023 (panorama.com.al) Ndërkohë, indeksi i kushtimit në ndërtim u rrit me 5.3%, nga niveli 7% një tremujor më parë.

31 tetor 2022 (panorama.com.al) Provo të arrish herët dhe të shijosh kënaqësinë e kushtimit të kohës vetes.

4 dhjetor 2024 (tvklan.al) Indeksi i Kushtimit në Ndërtim, në tremujorin e tretë 2024 arriti 112,3, kundrejt tremujorit të katërt 2021.

21 maj 2022 (tvklan.al) Të mos i fshihet publikut as në mënyrë të qëllimshme dhe as në mënyrë të papërgjegjshme për arsye të kushtimit të vëmendjes të çështjeve periferike.

Duhet të theksohet fakti se numri shumë, fjala *kushtime* është përdorur i gjithë në sinonimi me fjalën *dedikime*.

24 gusht 2018 (panorama.com.al) Aty vinin, për të bërë blatime, kushtime (aferoma).

17 shkurt 2025 (balkanweb.com) Po kështu përpiqem që atyre që më dërgojnë libra të veçantë dhe me dedikime të caktuara, t’u kthej edhe përgjigje.

➤ *fenomen-dukuri*

Foljen *dukem*, Çabej e konsideron me etimologji të diskutuar. Dëshmohet së pari te Buzuku. Prej foljes ka dalë emri *dukë* ‘pamje’ në toskërishten jugore. Prej kësaj fjale është krijuar me prapashtesë emri *dukuri*. Është fjalë e mbarë shqipes.²¹

Në Fjalorin e Shqipes, përkufizimi i dhënë për fjalën *dukuri* është:

1. term në filozofi; shprehja e jashtme a shfaqja e thelbit të sendeve e të proceseve: thelbi dhe dukuria.
2. çdo shfaqje e diçkaje, që buron nga veprimi i forcave a i shkaqeve të caktuara; fakt; ngjarje: dukuri atmosferike; dukuri shoqërore (gjuhësore).

Fjala fenomen, në kuptimin e parë është dhënë si një sinonim i fjalës dukuri, por ka dhe një kuptim të figurshëm: *njeri me prirje dhe aftësi të jashtëzakonshme: është fenomen*.

Prandaj, në analizën e fjalës *fenomen*, kemi marrë në konsideratë dhe faktin që kjo fjalë përdoret dhe ky kuptim i saj. Në këtë rast kjo fjalë nuk është sinonimi me fjalën *dukuri* të shqipes, prandaj nuk është përfshirë në këto statistika.

8 qershor 2024 *Fenomeni i ndotjes së liqenit të Komanit tashmë është bërë një fenomen shqetësues dhe i përvitshëm.*

26 mars 2024 *Kemi të bëjmë me një fenomen natyror të zhvendosur nga Afrika Veriore.*

²¹ Çabej. E. *Studime etimologjike në fushë të shqipes III*. Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë. Tiranë, 1987, f.352.

6 janar 2025 Fill pas Labinotit, vrasjet u bënë dukuri e zakonshme.

5 prill 2024 [...] ai vjen në ujëra të cekëta kur ka një dukuri sizmike.

Të dhënat statistikore të paraqitura në Tabelën 18 përfshijnë vetëm përdorimet e fjalës *fenomen* në vlerën e një sinonimi të plotë të fjalës *dukuri* të shqipes. Sikurse shihet nga Tabela 18, duket se ka një prirje drejt përdorimit të fjalës *dukuri*, pasi denduria e përdorimit të fjalës shqipe *dukuri* në të gjitha trajtat e saj është shumë herë më e madhe nga fjala e huazuar nga gjuha italiane *fenomen* (242957/30979).

Tabela 18. Numri i përdorimit të fjalëve: *fenomen* ↔ *dukuri*

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
fenomen	3280	1580	5690	2426
fenomeni	2070	684	3550	1422
fenomenit	469	108	1150	392
fenomenin	792	207	1580	488
fenomene	574	244	1240	507
fenomenet	1	54	584	252
fenomeneve	498	58	700	311
fenomenesh	19	5	35	9
dukuri	103,000	305	142000	377
dukuria	28	13	180	62
dukuritë	33	8	223	49
dukurisë	8	2	108	16
dukurinë	57	9	143	24
dukurie	21	18	210	42
dukurish	1	1	17	4

➤ *kualitet-cilësi*

Emri *cilësi* është formuar nga përemri *cili/cila*. Përemri është formuar nga ndajfolja *si*. Etimologjia e kësaj fjale konsiderohet me burim të diskutueshëm, e lidhur me rrënjën indoevropiane. Dëshmohet që te Buzuku.²²

Në përkufizimin e fjalës *cilësi* janë dhënë disa kuptime të saj.

CILËSI f.

1. *Veti thelbësore, tipar i veçantë i brendshëm (zakonisht veti e mirë, tipar pozitiv), që e dallon një send ose një frymor nga sendet ose frymorët e tjerë dhe që na jep mundësi ta njohim e ta vlerësojmë. Cilësi të mira (të rralla). Cilësi të larta. Cilësitë kryesore. Cilësitë e përbashkëta.*

2. *vet. nj. Të qenët i mirë e i dobishëm nga një anë e caktuar, shkalla e vlerës ose e dobisë që ka një send, një veprim etj.; të qenët ashtu si duhet të jetë një send, një veprim etj.; shkallë pak a shumë e lartë e vlerave ose e dobisë së diçkaje. Cilësi e mirë (e keqe*

3. *filoz. Tipari thelbësor ose tërësia e tipareve thelbësore që tregojnë se ç'është një send, një dukuri a një proces dhe që e dallojnë atë nga një send, një dukuri a një proces tjetër; tipari a tërësia e tipareve që përbën të veçantën e një sendi, dukurie a procesi, që e bën atë të jetë ai ose ajo që është, të shquhet nga sendet, dukuritë e proceset e*

²² Topalli K. *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*. Akademia e Studimeve. Albanologjike, Tiranë, 2017.

tjera dhe të lidhet me to. Cilësia dhe sasia. Kalimi (shndërrimi) i sasisë në cilësi. Ndryshime në cilësi.

4. drejt. Detyrë, rol a funksion, që merr një njeri, zakonisht për një kohë dhe për një rast të caktuar. Në cilësinë e paditësit.

5. shah. Ndryshimi në lojë ndërmjet një figure kryesore dhe një figure tjetër të lehtë që sjell epërsinë e njërit lojtar. Kam një cilësi me tepër. Humbas një cilësi.

Fjala *kualitet* nuk është përfshirë në Fjalorin e Shqipes.

Tabela 19. Numri i përdorimit të fjalëve: *kualitet* ↔ *cilësi*

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
kualitet	466	123	2390	139
kualiteti	184	50	520	65
kualitetit	81	9	111	29
kualitetin	207	28	788	87
kualitete	113	28	1050	42
kualitetet	390	15	2140	33
kualiteteve	23	8	37	6
kualitetesh	0	0	6	0
cilësi	4060	3577	12200	1679
cilësia	2000	340	4320	1024
cilësitë	1190	90	6750	571
cilësisë	2870	418	4430	1423
cilësinë	12900	2460	17200	5732
cilësie	352	54	565	199
cilësish	43	23	56	6

Të dhënat statistikore dëshmojnë për një përdorim gati dhjetë herë më të madh të fjalës shqipe *cilësi*, me 86532 raste përdorimi në të gjitha trajtat e saj, krahasuar me fjalën *kualitet* (9168).

Fjalët *kualitet* dhe *cilësi* trajtohen si fjalë sinonimike, përveçse në përdorimin e fjalës *cilësi* në ligjërimin juridik:

12 mars 2012 (panorama.com.al) Kanë bërë ankim kundër kreut të shtetit, në cilësinë e firmëtarit të dekreteve të shkarkimit.

16 shkurt 2025 (balkanweb.com) Arma e zjarrit u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

19 shkurt 2025 (tvklan.al) Duhet të paraqitet në Prokurori në cilësinë e dëshmitarit në një rast të hapur lidhur me dyshimet për keqpërdorime me rezervat shtetërore.

28 shkurt 2025 (euronews.al) Gjykata merr vendim për thirrjen e Kurtit në cilësinë e dëshmitarit.

Jo rrallë hasen dhe përdorime të italianizhmës *kualitet* dhe të fjalës *cilësi* brenda të njëjtit tekst, duke u trajtuar si fjalë me sinonimi të plotë.

13 dhjetor 2024 (balkanweb.com) Kosova ka kualitet, një fillim i mbarë mund t'u sjellë shpresë.

13 dhjetor 2024 (balkanweb.com) Kemi cilësi dhe mund të luajmë mirë.

14 janar 2025 (euronews.al) Jemi ekip me kualitet.

14 janar 2025 (euronews.al) Ne jemi skuadër që kemi cilësi dhe nivel.

Në ligjërimin e folur nuk mungojnë rastet kur folësit i përdorin fjalët *kualitet* dhe *cilësi* dhe brenda një fjalie, gjë që duhet shmangur, pasi shprehin të njëjtin kuptim. Raste të tilla gjenden dhe në mediat e analizuara, por kryesisht në intervista.

27 shtator 2022 (panorama.com.al) Tani kemi më shumë kualitet, më shumë cilësi.

28 nëntor 2024 (balkanweb.com) Kamara është lojtar shumë i vlefshëm, ka cilësi dhe kualitet.

➤ *mentalitet-mendësi*

Fjala *mend* është një fjalë e vjetër e shqipes që dokumentohet që te Buzuku. Konsiderohet huazim latin *mentem*.²³

Në Fjalorin e shqipes, fjala *mentalitet* është dhënë si e njëvlershme nga ana kuptimore me fjalën *mendësi*, për të cilën jepet përkufizimi: mënyra se si e mendojmë dhe e kuptojmë botën; tërësia e pikëpamjeve dhe e shprehive të një njeriu a të një grupi shoqëror; mentalitet: njerëz me mendësi të ndryshme.”

Të dhënat e paraqitura në Tabelën 20, flasin për një përdorim shumë herë më të madh të huazimit nga italishtja *mentalitet*, në të gjitha trajtat e lakimit. Numri i përgjithshëm i përdorimit të fjalës *mentalitet* është 11722, ndërsa i fjalës *mendësi* është 2904. Ky parapëlqim për fjalën *mentalitet* mund të shpjegohet jo vetëm me një traditë të përdorimit të saj në gjuhën shqipe, por dhe me ndikimin që ka sot fjala *mentality* e anglishtes, (një huazim latin në gjuhën angleze, përmes frëngjishtes²⁴), pasi një pjesë e mirë e lajmeve dhe e studimeve që publikohen në media përkthehen nga gjuha angleze.

²³ Çabej E. *Studime etimologjike në fushë të shqipes V*. Botime Çabej, Tiranë, 2014, f.317.

²⁴ Words in English: Latin and Greek Morphology.

13 dhjetor 2024 (balkanweb.com) Rutte: Ka ardhur koha për të kaluar në mentalitetin e luftës!

9 dhjetor 2022 (panorama.com.al) Duhet përgëzuar Rodrigo pasi të gjuash një penallti në këtë ndeshje, tregon forcë dhe mentalitet.

24 janar 2025 (tvklan.tv) Këtë, Ukraina dhe perëndimi e konsiderojnë si "mentalitet të vjetër perandorak".

Tabela 20. Numri i përdorimit të fjalëve: mentalitet ↔ mendësi

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
mentalitet	576	309	2810	363
mentaliteti	459	226	2140	406
mentalitetin	468	92	2370	310
mentalitetit	68	35	644	167
mentalitete	8	3	120	33
mentalitetet	9	2	68	17
mentalitetesh	0	0	17	2
mendësi	186	184	725	129
mendësia	22	28	330	56
mendësisë	18	14	243	42
mendësinë	253	34	427	86
mendësitë	8	4	86	20
mendësish	0	1	7	1

Mentalitet dhe mendësi përdoren si fjalë me sinonimi të plotë në mediat e analizuar:

10 dhjetor 2024 (balkanweb.com) Një mentalitet që i konsideron gratë si pronë.

10 dhjetor 2024 (balkanweb.com) Gratë, bashkë me burrat, kanë nevojë për revolucion në mendësi.

24 korrik 2014 (panorama.com.al) Kjo u sjell të katërve një mentalitet tejet të ri, shumë ndryshe nga çfarë jemi mësuar në këto vite.

24 korrik 2014 (panorama.com.al) Por më shumë se kaq, një mendësi të re të të bërit politikë, sidomos politikanë e pranimi të tjetrit aq shumë të munguar që nga viti 1990.

11 shkurt 2021 (euronews.al) Ne mendojmë që partitë politike në Kosovë, janë duke shpërfaqur përsëri mentalitetin e tyre konservator.

11 shkurt 2021 (euronews.al) Kjo situatë po cilësohet si mendësi patriarkale e vetë partive politike.

Në intervista hasen dhe përdorime të të dyja fjalëve brenda së njëjtës fjali. Sigurisht që një përdorim i tillë është tregues i qasjes që kanë të intervistuarit ndaj këtyre fjalëve, që edhe pse janë fjalë me kuptim të njëjtë, i përdorin si dy fjalë me kuptime të ndryshme. Gazetarët bëjnë vetëm zbardhjen e intervistave, pa ndërhyrë në fjalët e folësit, prandaj shembujt e mëposhtëm janë dhënë vetëm për të dëshmuar qëndrimin që kanë folësit e shqipes ndaj përdorimit të italianizmave dhe fjalëve të shqipes apo të huazimeve më të vjetra të shqipes.

8 korrik 2014 (panorama.com.al) Kanë të njëjtën mendësi dhe të njëjtin mentalitet në mënyrën e funksionimit të qeverisjes.

16 mars 2021 (panorama.com.al) Emisioni ku ajo mori pjesë, përpos frazës që u bë hit, tregoi këtë mendësi dhe këtë mentalitet.

30 gusht 2021 (panorama.com.al) Forcë përfaqësuese e rinisë kryesisht, por edhe e më të rriturve me mendësi, mentalitet dhe vizion të ri.

14 shkurt 2025 (euronews.al) Von der Leyen tha se Evropa ka potencialin të “lëvizë malet” kur adopton një “mentalitet urgjence”.

➤ *koordinoj-bashkërendoj*

Në Fjalor, fjalët *koordinoj* dhe *koordinim* konsiderohen si fjalë të ligjërimit libror, me kuptim të njëjtë me fjalët *bashkërendoj* dhe *bashkërendim*.

BASHKËRENDOJ kal.

Lidh së bashku në mënyrë të harmonishme veprime, dukuri etj. për të arritur një qëllim, i vë ato në marrëdhënie të caktuara sipas një qëllimi; bëj që të përputhen si duhet disa veprime, dukuri etj. Bashkërendoj detyrat. Bashkërendoj forcat (përpyjekjet, ndihmën).

BASHKËRENDIM m.

Veprimi sipas kuptimeve të foljeve BASHKËRENDOJ, BASHKËRENDOHET. Bashkërendim i plotë. Bashkërendimi i veprimtarisë (i punës, i detyrave, i forcave, i planeve).

** Në bashkërendim me... libr. në pajtim a në përputhje me..., duke u bashkërenduar me...*

Folja *bashkërendoj* është një fjalë e përbërë, që nga ana strukturore është një kalk gjuhësor i fjalës *koordinare* (co+ordinare), *bashkërendoj* (bashkë+rendoj).

Të dhënat e Tabelës 21 dëshmojnë për një përdorim më të lartë të foljes së huazuar nga italishtja *koordinoj* me 6200 raste përdorimi, krahasuar me 1213 rastet e përdorimit të foljes *bashkërendoj*.

Tabela 21. Numri i përdorimit të fjalëve: koordinoj ↔ bashkërendoj

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
koordinon	30	68	193	85
koordinoi	3	10	52	20
koordinohet	26	58	385	111
koordinohen	9	55	195	98
koordinuar	1550	629	1840	783
koordinimi	318	580	651	301
koordinimit	687	196	902	463
koordinim	1600	1956	1630	879
koordinimin	905	264	989	480
koordinime	0	15	11	6
koordinimeve	911	6	1000	5
bashkërendon	101	6	438	5
bashkërendoi	3	5	8	7
bashkërendohet	1	7	28	16
bashkërendohen	5	4	23	8
bashkërenduar	31	81	301	135
bashkërendim	28	130	318	150
bashkërendimi	20	76	115	44
bashkërendimit	19	20	156	66
bashkërendimin	20	36	175	71
bashkërendime	0	1	1	1
bashkërendimet	0	1	0	2
bashkërendimeve	20	0	175	2

Edhe më i dukshëm është parapëlqimi për fjalën e huazuar në rastin e emrit *koordinim* (i formuar nga folja *koordinoj*+prapashtesën *im*, në të gjitha trajtat rasore të njëjësit dhe shumësit). Numri i përgjithshëm i përdorimeve të emrit *koordinim* është 14755 dhe i emrit *bashkërendim* është 1647 herë.

Mendojmë se përdorimi më i lartë i foljes *koordinoj* dhe i emrit *koordinim* mund të ketë lidhje me huazimet nga gjuha angleze *to coordinate, coordination*, që janë fjalë tipike të teksteve administrative dhe juridike.

Në mbështetje të kësaj ideje, do të përmendnim faktin që fjala *koordinim* përdoret dhe në emërtimet e institucioneve shtetërore, si p.sh. *Komiteti i Koordinimit dhe Menaxhimit të Emergjencave Civile*²⁵ që është një përkthim i një emërtimi në gjuhën angleze “Committee in Management&Co-ordination”.

Po ashtu, *koordinim* haset dhe në terminologjinë parlamentare, zgjedhore etj: *Protokolli i Koordinimit për parlamentaret 2025* etj.

Formulime të tipit *në bashkëpunim me, në bashkëveprim me* janë pjesë e rëndësishme e leksikut të institucioneve zyrtare. Dhe krahas tyre përdoret dhe *në koordinim me*.

12 shkurt 2025 (balkanweb.com) *Si rezultat i hetimeve dhe veprimeve operacionale, të kryera në koordinim me partnerët italianë.*

12 shkurt 2025 (balkanweb.com) *Në bashkëpunim me DVP Lezhë, me Zyrën e Interforcës Italiane në Shqipëri ...*

10 nëntor 2014 (panorama.com.al) *Bashkëpunim dhe koordinim në interes të të dy vendeve.*

²⁵ Qeveria Shqiptare Keshilli i Ministrave.

➤ *influencë-ndikim*

Folja *ndikoj* “lë gjurmë, nxis” është fjalë kryesisht e gegërishtes, e përgjithësuar në shqipen e sotme. Lidhet përbrenda gjuhës me *dëkon* “derdh, rrjedh, pikon”. Nga folja *ndikoj* është formuar emri *ndikim*.²⁶

Në Fjalorin e Shqipes jepen përkufizimet e mëposhtme për fjalët *ndikim* dhe *influencë*:

NDIKIM *m.*

1. *Veprimi sipas kuptimeve të foljeve NDIKOJ, NDIKOHET. Ndikim i madh (i thellë).*

2. *Autoriteti që ka dikush mbi dikë, forca e pushtetit. Njeri me ndikim të madh.*

3. *kryes. Pasojë e veprimit që ushtron dikush a diçka mbi një tjetër. Ndikime gjuhësore.*

INFLUENCË *f. libr.*

shih NDIKIM, ~I. Njeri me influencë. Sferat (zonat) e influencës. Ka influencë.

Në Fjalorin e Shqipes, për fjalën *influencë* nuk është përfshirë dhe një kuptim që ka kjo fjalë në italisht: *Sëmundje respiratore virale, e karakterizuar nga ethe, dhimbje koke, dhimbje muskulore.*

Nga përlllogaritja e të dhënave të paraqitura në Tabelën 22, rezultojnë 8214 raste të përdorimit të fjalës *influencë* dhe 62109 raste të përdorimit të fjalës *ndikim*.

²⁶ Topalli K. *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*. Akademia e Studimeve. Albanologjike, Tiranë, 2017, f.1038.

Tabela 22. Numri i përdorimit të fjalëve: *influcencë* ↔ *ndikim*

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
influcencë	676	377	1440	315
influenca	96	122	608	219
influence	1160	377	2060	98
influenca	21	22	193	50
influcencash	2	2	44	8
influcencave	109	15	155	45
ndikim	7220	3887	10500	3396
ndikimi	3340	2339	4750	1528
ndikimit	2160	582	3360	1053
ndikimin	4620	1183	6590	3007
ndikime	500	328	663	326
ndikimeve	70	61	442	145
ndikimesh	4	2	41	12

Këto dy fjalë janë përdorur kryesisht si fjalë sinonimike të plota, përveç rasteve, kur fjala *influcencë* është përdorur në kuptimin e sëmundjes respiratore.

23 dhjetor 2021 (panorama.com.al) Në kohën kur në shumë vende të botës është duke u përhapur varianti *Omicron* i koronavirusit dhe në të njëjtën kohë edhe virusi *Influenca A*.

4 nëntor 2024 (balkanweb.com) Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së *influcencës* aviare në shpendë.

26 shkurt 2025 (tvklan.tv) Kemi pasur prezencë të shtuar të *influcencës*, qoftë *A*, qoftë *B*.

10 shkurt 2025 (euronews.al) Janë disa tipe virusesh që kemi përqark, janë virusi i *Influcencës* me nëntipet e tij.

6 dhjetor 2022 (euronews.al) BE, garanci Ballkanit përballë influcencës ruse.

10 tetor 2021 (panorama.com.al) Ja çfarë thotë për influcencën ruse e kineze në rajon.

22 shkurt 2025 (euronews.al) Trump shpall rregulla të reja për të kufizuar ndikimin e Kinës.

4 janar 2025 (panorama.com.al) Në debatin e përhershëm mbi ndikimin e rrjeteve sociale në shëndetin mendor.

Sikurse është përmendur dhe për rastet e huazimeve të tjera, në mënyrë të veçantë në intervistat në media, hasen përdorime të të dyja fjalëve, me kuptim të njëjtë brenda së njëjtës fjali, gjë që duhet shmangur nga folësit.

21 nëntor 2019 (panorama.com.al) Është një union ekonomik me influcencë e ndikim të drejtpërdrejt rus.

➤ ofendoj-fyej

Sipas Çabejit, *fyej* është një fjalë e re e krijuar nga folja *fëjej*. Është fjalë e gegërishtes veriore që në këtë formë dialektore ka hyrë në gjuhë shkrimi.²⁷

Në Fjalor, folja *ofendoj* është dhënë me të njëjtin kuptim me foljen *fyej*:

OFENDOJ kal. libr. shih FYEJ. E ofendoi rëndë.

FYEJ kal. E cenoj, e prek në nder a në sedër dikë; poshtëroj. E ka fyer rëndë.

²⁷ Çabej E. Studime etimologjike në fushë të shqipes V. Botime Çabej, Tiranë, 1996, f.230.

Sipas të dhënave të paraqitura në Tabelën 23, vihet re se ka një përdorim pak më të lartë të formave të foljeve *ofendoj-fyej* (7251/6551), në vetën e tretë të së tashmes dhe të së kryerës së thjeshtë të dëftores. Numri i përdorimit të trajtave të foljes *ofendoj* është pak më i lartë se i foljes *fyej*. Po ashtu, ka një parapëlqim më të lartë për emrin *fyerje*, 7265 raste përdorimi krahasuar me 5294 raste të emrit *ofendim*, në të gjitha trajtat e tyre.

Tabela 23. Numri i përdorimit të fjalëve: *ofendoj ↔ fyej*

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
ofendon	33	64	977	130
ofendoi	32	513	1450	138
ofendohet	6	3	69	15
ofendohen	2	6	48	16
ofenduar	628	126	2540	455
ofendimi	3	10	79	30
ofendim	20	170	540	134
ofendimin	7	6	73	16
ofendime	188	133	1980	232
ofendimet	39	38	991	119
ofendimeve	16	26	395	49
fyen	237	114	964	172
fyer	848	853	2720	480
fyhet	9	4	69	15
fyhen	9	3	49	5
fyerje	1120	344	2720	555
fyerjes	21	15	160	39
fyerjen	22	16	210	46
fyerjet	192	86	913	177
fyerjeve	17	24	213	91
fyerja	17	22	191	54

Foljet *ofendoj* dhe *fyej* në të gjitha format e përdorimit të tyre, si dhe emrat e formuar prej tyre *ofendim* dhe *fyerje* janë sinonime të plota në gjuhën shqipe, prandaj përdoren shpesh në tekste për të shmangur përsëritjen e së njëjtës fjalë.

20 janar 2025 (balkanweb.com) Ai shtoi se personi që kishte shpërndarë videon e kishte ofenduar edhe disa herë para ngjarjes.

15 shkurt 2025 (balkanweb.com) Mesfushori i Los Blancos ka bërë një postim në rrjetet sociale, ku shkruan se gjithçka ishte keqkuptim dhe se nuk kishte fyer arbitrin.

20 dhjetor 2024 (tvklan.al) Kjo ka shkaktuar dhe përplasje fizike dhe ofendime mes tij dhe përfaqësueseve të tjerë të opozitës.

5 dhjetor 2024 (tvklan.al) Debate e fyerje, shtyhet seanca.

Foljet *ofendoj* dhe *fyej* dhe emrat e formuar prej tyre *ofendim* dhe *fyerje* përdoren në kontekste të njëjta shoqërore dhe nuk i përkasin gjuhës teknike. Ato nuk shprehin ngjyresa emocionale të ndryshme. Megjithatë, jo rrallë këto fjalë përdoren në të njëjtën fjalë, shpesh në funksion të përforcimit të kuptimit.

18 prill 2023 (panorama.com.al) Qeveria e Katalonjës sulmon Realin: Po manipuloni historinë, fyerje dhe ofendim.

1 nëntor 2024 (balkanweb.com) Për sjellje të gabuar të spektatorëve, duke hedhur sende në fushën e lojës si dhe duke ofenduar dhe fyer zyrtarët dhe drejtuesit e FSHF-së.

➤ *pasagjer-udhëtar*

Fjala *udhë* është fjalë e mbarë gjuhës duke përfshirë edhe arvanitasit dhe arbëreshët e Italisë. Çabej e konsideron si fjalë të trashëguar që lidhet përbrenda gjuhës me vete. Dëshmohet së pari te Buzuku, së bashku me fjalën *udhëtar*.²⁸

Fjala *pasagjer* është dhënë si fjalë sinonimike me fjalën *udhëtar*, në fjalor. Ka një përdorim të fjalës *udhëtar*, për të cilin kjo fjalë nuk mund të zëvendësohet nga fjala *pasagjer*: *Udhëtar i shquar*.

UDHËTAR m.

1. Ai që bën një udhëtim për të shkuar në një vend tjetër, zakonisht të largët; ai që është në udhë e sipër; ai që udhëton me një mjet. *Udhëtar i largët (nga vise të largëta). Udhëtarët e trenit.*

2. Ai që bën udhëtime të gjata për të njohur ose për të zbuluar vende të tjera. *Udhëtar i shquar (i njohur, i dëgjuar).*

PASAGJER m.

Udhëtar në një mjet. Treni i pasagjerëve. Vagon pasagjerësh. Hipin (zbresin) pasagjerë.

Sikurse shihet nga rastet e përdorimit të paraqitura në Tabelën 24, fjala *pasagjer*, në të gjitha rasat e lakimit, ka një përdorim 3 herë më të madh nga fjala *udhëtar*: 34369 raste përdorimi të fjalës *pasagjer*, 12156 raste të përdorimit të fjalës *udhëtar*.

²⁸ Topalli K. Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe. Akademia e Studimeve. Albanologjike, Tiranë, 2017, f.1038.

Tabela 24. Numri i përdorimit të fjalëve: pasagjer ↔ udhëtar

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
pasagjer	1160	1783	1250	1021
pasagjeri	909	270	1000	415
pasagjerin	2440	27	2520	64
pasagjerit	394	64	635	238
pasagjerë	2350	1365	2410	1467
pasagjerët	2250	534	2320	1262
pasagjerëve	1520	440	1570	1072
pasagjerësh	485	534	324	276
Udhëtar	173	1086	177	235
udhëtari	101	35	145	51
udhëtarin	13	5	18	7
udhëtarit	37	15	65	17
udhëtarë	469	1040	517	452
udhëtarët	1240	664	1180	892
udhëtarëve	864	310	1040	801
udhëtarësh	156	55	141	155

Numri më i lartë i përdorimit të këtyre fjalëve është në shumës.

3 prill 2024 (balkanweb.com) Drejtuesit e aeroportit kanë parashikuar që për vitin 2024 të mirëpresin mbi 9 milion pasagjerë.

18 shkurt 2025 (euronews.al) Pasagjerët tregojnë tmerrin në avion.

30 nëntor 2024 (balkanweb.com) Stuhia e borës “paralizon” New York-un, shpallet gjendja e jashtëzakonshme, paralajmërimi për udhëtarët.

1 gusht 2022 (euronews.al) Pesë mijë udhëtarë hynë në portin e Durrësi.

Ndër përdorimet e fjalës *pasagjer* në numrin njëjës, duhet të veçohet përdorimi i saj në kuptimin e personit që udhëton me një mjet, por nuk e drejton atë. Në këto raste, kjo fjalë, zakonisht, nuk zëvendësohet nga fjala *udhëtar*.

19 tetor 2023 (euronews.al) *Makina merr flakë në ecje, shoferi dhe pasagjeri përfundojnë në spital.*

5 dhjetor 2021 (panorama.com.al) *Aksident në Korçë/ Shoferi i "Audit" humb kontrollin dhe del nga rruga, përfundon në spital bashkë me pasagjerin.*

➤ *tavolinë-tryezë*

Fjala *tryezë* është një fjalë e vjetër në gjuhën shqipe që dokumentohet që në veprën e Buzukut. Mendohet se është një huazim nga greqishtja.²⁹ Fjala *tavolinë* në fjalor është dhënë si një fjalë me kuptim të njëjtë me fjalën *tryezë*.

TRYEZË f.

1. *Orendi prej druri, prej metali etj. zakonisht me këmbë, me syprinë të rrafshët katërkëndëshe a të rrumbullakët, mbi të cilën mbajmë diçka, vendosim gjërat e nevojshme kur punojmë, kur hamë etj. Tryezë e gjatë (e rrumbullakët, katrore, e madhe, e vogël). Tryezë e lëvizshme. Tryezë pune.*

2. *Ushqimet e sendet e tjera që vëmë në këtë orëndi; njerëzit që rrinë rreth saj. Tryezë e pasur.*

3. *bised. Gosti që shtrohet për nder të dikujt ose me rastin e një ngjarjeje të shënuar. Shtroi një tryezë.*

²⁹ Topalli K. Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe. Akademia e Studimeve. Albanologjike, Tiranë, 2017, f.1496.

4. *fig. Mjedis i kufizuar ku zhvillohet një bisedë, ku kryhet një punë a veprimtari etj. Tryeza e bisedimeve.*

5. *përd. mb. Që është i përshtatshëm për t'u ngrënë ose për t'u pirë gjatë drekës, darkës etj. Rrush tryeze.*

* *Tryeza (coha) e gjelbër vjet. shih te GJELBËR (i,e). Tryeza e rrumbullakët*

a) *mbledhje ku marrin pjesë përfaqësues të palëve të ndryshme për të rrahur një çështje nga pozita të barabarta;*

b) *diskutim që organizohet zakonisht në redaksinë e një gazete a reviste për të rrahur një çështje me një grup njerëzish.*

TAVOLINË f.

Tryezë. Tavolinë buke (pune, shkrimi). Tavolinë shahu.

Ndër kuptimet më të përdorura të kësaj fjale në media, është kuptimi figurativ “Mjedis i kufizuar ku zhvillohet një bisedë, ku kryhet një punë a veprimtari.”. Formime të tilla si: *tryezë pune, tryezë bisedimesh, tryeza e bisedimeve, tryezë me (biznesin), tryezë për (reformën), janë ulur në tryezë etj. janë fjalë tipike të leksikut politike dhe juridik dhe hasen shumë shpesh dhe në media.*

15 tetor 2014 (panorama.com.al) *Të pranishëm në këtë tryezë pune do të jenë përfaqësues edhe në nivel politik, ndonëse vendin kryesor do ta ketë përfaqësimi i ekspertëve në nivel teknik.*

25 shkurt 2022 (panorama.com.al) Zelensky fton Vladimir Putinin në tryezë bisedimesh.

16 shkurt 2025 (tvklan.al) I dërguari i Trump: Evropa mund të mos jetë në "tryezën" e bisedimeve për paqe në Ukrainë

9 nëntor 2013 (panorama.com.al) AKIP, tryezë me ekspertët për armët kimike

23 tetor 2024 (balkanweb.com) Raundi i radhës i dialogut Kosovë-Serbi, palët ulen në tryezë me Lajçak, nisin takimet në Bruksel.

1 qershor 2020 (euronews.al) Reforma zgjedhore, opozita kërkon tryezë për gjetjen e konsensusit.

Numri i përdorimeve të fjalës *tryezë* në të gjitha trajtat e lakimit të saj është pak më i lartë nga numri i përdorimeve të fjalës *tavolinë*, përkatësisht 27183 dhe 24998 raste përdorimi.

Numri i lartë i përdorimit të trajtave *tryezë*, *tryezën*, mund të shpjegohet me përdorimin e këtyre fjalëve edhe si pjesë e formulimeve të dhëna në shembujt e mësipërm. Duhet të theksohet fakti se parapëlqehet më shumë fjala *tryezë* në formimet e tipit: *tryezë pune*, *tryezë bisedimesh*. Fjala *tavolinë* haset më shpesh e përdorur në kuptimin e parë, si dhe në kuptimin e figurshëm:

10 janar 2025 (tvklan.al) Këto janë pamjet brenda apartamentit, ku në tavolinë duken dy pistoletat.

12 shtator 2024 (balkanweb.com) Opsionet janë në tavolinë.

5 tetor 2020 (panorama.com.al) Prapaskenat/Juventusi fiton 3-0 në tavolinë, ja pse e pësoi Napoli.

6 mars 2023 (euronews.al) Jashari: Luftën që fituam me gjak nuk mund ta humbim në tavolinë.

Tabela 24. Numri i përdorimit të fjalëve: pasagjer ↔ udhëtar

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
tavolinë	3760	765	8410	1758
tavolina	780	239	1840	474
tavolinës	234	67	893	264
tavolinën	910	166	1980	555
tavolinat	194	78	740	210
tavolinave	29	43	327	99
tavolinash	6	5	59	13
tryezë	3830	1139	4030	1643
tryeza	628	206	1370	498
tryezës	288	96	783	402
tryezën	3860	516	2750	1390
tryeza	628	206	1370	498
tryezat	139	66	412	170
tryezave	24	13	146	53
tryezash	1	0	20	8

PËRFUNDIME

Ky studim, i cili ka në fokus frekuencën e përdorimit të disa italianizmave në gjuhën shqipe, tregon se ka në përgjithësi ka një frekuencë përdorimi më të lartë të fjalëve të shqipes ose të huazimeve të vjetra në shqipe, në krahasim me italianizmat e marra në shqyrtim.

- *braktis*, një huazim i vjetër, duket se është bërë pjesë e plotë e leksikut të shqipes dhe parapëlqehet ndaj italianizms *abandonoj* dhe formimit të shqipes, prej saj, *abandonim*.

- Fjala *devocion*, e huazuar nga italishtja, përdoret në shifra gati të papërfillshme në krahasim me fjalën *përkushtim*.
- Ka një parapëlqim më të madh për foljen *miratoj* se sa për foljen *aprovoj*.
- Të dhënat dëshmojnë për një parapëlqim më të madh për trajtat e foljes *kushtoj* krahasuar me foljen *dedikoj*.
- Fjala *dukuri* ka denduri më të lartë përdorimi nga fjala *fenomen*.
- Të dhënat statistikore dëshmojnë për një përdorim gati dhjetë herë më të madh të fjalës shqipe *cilësi*, krahasuar me fjalën *kualitet*
- Fjalët *vendës/vendas* kanë një numër përdorimi shumë herë më të madh nga fjala *autokton*.
- Fjala *ndikim* ka një numër shumëfish më të lartë përdorimi nga fjala *influcencë*.
- Numri i përdorimeve të fjalës *tryezë* në të gjitha trajtat e lakimit të saj është pak më i lartë nga numri i përdorimeve të fjalës *tavolinë*.
- Ka një parapëlqim më të lartë për emrin *fyerje*, krahasuar me fjalën *ofendim*, në të gjitha trajtat e tyre.

Për shkak të ndikimit të gjuhës angleze, ka dhe italianizma që përdoren më shumë nga fjalët e shqipes, apo huazimet e vjetra të shqipes:

- Ka një përdorim shumë herë më të madh të huazimit nga italishtja *mentalitet*, në të gjitha trajtat e lakimit, nga fjala *mendësi*.
- Italianizmat *koordinoj* dhe *koordinim* kanë një numër shumë herë më të madh se fjalët *bashkërendoj* dhe *bashkërendim*.

- Ka një përdorim pak më të lartë të formave të foljes *ofendoj* krahasuar me foljen *fyej*.
- Fjala *pasagjer*, në të gjitha raset e lakimit, ka një përdorim 3 herë më të madh nga fjala *udhëtar*.

Analiza e të dhënave tregon për një prirje të përgjithësuar drejt fjalëve të shqipes apo fjalëve që janë bërë herët pjesë e leksikut të shqipes dhe një rritje të italianizmave që vijnë si rrjedhojë e shtimit të numrit të anglicizmave me kalimin e kohës.

Studime të tilla të mëtejshme janë të domosdoshme për të përcaktuar sasinë dhe masën e kësaj prirjeje, por për të hetuar dhe shkaqet pse fjalë të caktuara të gjuhës italiane janë më të pëlqyera se fjalët e shqipes.

3. HUAZIMET NGA GJUHA ANGLEZE

Anglishtja, me varietetet e saj të ndryshme gjeografike dhe sociale, është sot gjuha më e përhapur dhe më me ndikim. Përdorimi i anglishtes në shkencë, teknologji, biznes ndërkombëtar etj. i ka dhënë një përparësi strategjike duke e bërë gjuhë globale apo *lingua franca* të botës moderne³⁰.

Ndikimi i anglishtes nuk është i kufizuar në numrin e madh të folësve, por shtrihet në ndikimin që ka në gjuhë të tjera. Studimet flasin për një ndikim shumë të madh të gjuhës angleze, prej filmave, televizionit, internetit etj. jo vetëm në huazimet e fjalëve, por dhe në formimin kulturor etj. Por ndikimi më i dukshëm i gjuhës angleze në gjuhët e tjera është futja e fjalëve të gjuhës angleze në shumë gjuhë. Mbizotërimi i gjuhës angleze në teknologji dhe kulturën *pop* ka çuar në huazimin e shumë fjalëve të gjuhës angleze të këtyre fushave.

Depërtimi i huazimeve nga anglishtja në gjuhë të ndryshme është trajtuar gjerësisht nga studiues të shumtë. Gjuhëtarët puritanë në disa vende e shohin këtë si një kërcënim për pastërtinë dhe identitetin e gjuhëve të tyre amtare. Për valët e futjes së anglicizmave në gjuhë të ndryshme flitet për shumë dhjetëvjeçarëve,

³⁰ Kowner R., Rosenhouse J. Globally Speaking. Motives for Adopting English Vocabulary in Other Languages. Multilingual Matters, 2008. F.4. <https://doi.org/10.21832/9781847690524-004>.

Tullio de Mauro e konsideron futjen e fjalëve të gjuhës angleze në gjuhën italiane, nga vitet '80 të shekullit të kaluar e deri në ditët e sotme, si një cunam 'tsunami anglicus'.³¹

Ka shtete që synojnë që përmes akademive dhe politikave gjuhësore të shmangin ose të pengojnë depërtimin e huazimeve nga gjuha angleze dhe të nxisin përdorimin e fjalëve të gjuhës amtare.

Edhe huazimet angleze në gjuhën shqipe kanë qenë në fokus të studimeve të shumë gjuhëtarëve si: Jani Thomai, Agron Duro, Xhevat Lloshi, Valter Memisha, Hajri Shehu, Irena Pata, Nebi Caka, Vesel Nuhiu, Rrahman Paçarrizi etj.

Gjuhëtarët shqiptarë kanë pasur këndvështrime të ndryshme në lidhje me huazimet nga gjuha angleze. Ka fjalë të cilat nuk mund të konsiderohen anglicizma të mirëfilltë, pasi janë futur përmes gjuhëve të tjera. Kështu, Xh. Lloshi, i referohet përkufizimit të dhënë nga gjuhëtari italian, G. Devoto në fjalorin e italishtes, për termin *anglicizëm*: "Fjalë, togfjalësh ose ndërtim përkatës i anglishtes, që është huazuar ose në trajtën origjinale (slogan, leader), ose përmes përshtatjes (tranvai). Edhe fjalë që përdoret jo drejt me kuptimin që ka në anglishten; p.sh. 'lettura' nga lecture për 'konferencë' ose për 'ligjëratë e nivelit të lartë' [nga frëngj. anglicisme dhe kjo nga lat. mesj. anglicus]." Bazuar në këtë përkufizim, Lloshi konsideron si huazime të anglishtes në gjuhën shqipe fjalët që

³¹ Mauro T. *È irresistibile l'ascesa degli anglismi?* <https://www.internazionale.it/opinione/tullio-de-mauro/2016/07/14/irresistibile-l-ascesa-degli-anglismi>. Leximi i fundit, 25 janar 2025.

rrjedhin nga dukuria e gjuhëve në kontakt, e shqipes me anglishten.³²

Sipas Lloshit, fjalët e gjuhës angleze kanë hyrë në gjuhën shqipe që në fillim të shekullit XX dhe një pjesë e tyre është përfshirë dhe në Fjalorin e Shqipes të vitit 1954. Një listë jo e plotë e këtyre huazimeve më të hershme të anglishtes në shqip, sipas studiesit Lloshi, janë:

ajsberg, apartejd, autostop, bar, basketboll, bejsboll, benxh, biftek, bihejviorizëm, bitëlli, biznes, biznesmen, blister, bluxhins (xhinse), bluz, bojkot, bojkotoj, bojskaut, bojskautizëm, boks, bokser, boksier, bos, brixh, buldozer, bum, bumerang, buxhet, cent, çarleston, dendi, destroyer, dok, dollar, doping, dragë, faull, film, finish, flirt, flirtoj, futboll, gangster, gol, golaverazh, golf, grejpfrut, hamburger, handikapat, hendboll, hipi, hokej, huligan, import, importoj, inç, jaht, janki, kauboj, kek, king, klub, klloun, kokakola, koks, koktej, komiks, kompjuter, kongresmen, kontejner, kros, kultivar, laburist, lazer, ledi, lider, lidershhip, linçoj, liliput, lobizëm, lokaut, lord, marins, mikser, miting, napalm, nokaut, nokdaun, okej (OK), pas, pasoj, paund, penallti, peni (pens), piknik, pop art, pulovër, ramstek, raund, refer, ring, rokenroll, rum, samit, sandviç, skrap, skreper, slogan, snajper, snob, snobizëm, spidometër, spiker, sprint, sprinter, standard, start, sterlinë, stop, stres, striptizë, stuardesë, suing, sherif, shilingë, shut, tank, tenis, trajler, trajner, trejning, traktor,

³² Lloshi Xh. Raste ndërhyrjes të huazimeve nga anglishtja. https://albanica.al/studime_filologjike/article/view/3278/3198. *Studime filologjike*, Nr.1-2, 2011, f.63.

*transistor, tredunion, trust, tuist, tunel, uestern, uiski, vat, vaterpolo, volejbol, xhaz (xhez), xhaul, xhentëlmen, xhin, xhinse, xhips, xhol etj.*³³

Sipas studiuesit Jani Thomai, huazimet nga anglishtja (terminologjia sportive) kanë hyrë në gjuhën shqipe në vitet 20-të të shekullit XX bashkë me fjalë nga gjuhët neolatine, si frëngjishtja e italishtja.³⁴

Studimet tregojnë se politikat gjuhësore në Shqipëri, para viteve '90, kishin në fokus pastrimin e shqipes nga huazimet e gjuhëve të tjera. Megjithatë, pati dhe anglicizma të cilat vazhduan të përdreshin dhe gjatë atyre viteve: *penallti, pulovër, boks, boksier, faull, sherif, kameraman, shut, futboll, basketboll, kauboj etj.*³⁵

Huazimet angleze filluan të depërtonin në Shqipëri pas viteve 1990, me ndryshimin e sistemit politik, duke mbizotëruar në ligjërimin politik, në terminologjinë administrative, në ligjërimin e medias etj. Gjatë viteve të fundit, bashkë me evolucionin teknologjik është rritur ndjeshëm ndikimi e gjuhës angleze, pasi zhvillimi i teknologjisë shpesh fillon në vendet anglishtfolëse dhe më pas përhapet në gjuhët e tjera. Termat e teknologjisë janë futur gjerësisht në leksikun e shqipes, duke u bërë pjesë e fjalorit të përditshëm. Që nga fundi i viteve '90 kur interneti filloi të përhapej, fjalë të tilla si: *email* (imejl), *spam* (spem), *web* (ueb), *browser* (brouser), *online* (onlajn), *file* (fajl), *link* (link)

³³ Lloshi Xh. Raste ndërhyrjes të huazimeve nga anglishtja. https://albanica.al/studime_filologjike/article/view/3278/3198. *Studime filologjike*, Nr.1-2, 2011, f.73.

³⁴ Mahmudi, M. Anglizma, vendi dhe përdorimi i tyre në shqipen e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut. Punim doktore. F.26.

³⁵ Pata I. Aspekte të kontaktit gjuhësor mes shqipes e anglishtes. Revista "Studime filologjike", Nr.3-4, Tiranë, 2020, f.187.

etj. janë bërë sot terma të zakonshëm në shumë gjuhë, edhe në shqip. Termat bazë të terminologjisë janë bërë sot pjesë e fjalorit të shqipes *software* (softuer), *hardware* (harduer) *gigabyte* (gigabajt) etj.

Duhet thënë se një pjesë e termave të huazuara nga anglishtja, me kalimin e viteve janë zëvendësuar me anë të fjalëve të vetë shqipes, si në rastin e terminologjisë bazë për kompjuterin: *to download* (*dounlodoj*³⁶)-*shkarkoj*, *to upload* (*aplodoj*)-*ngarkoj*, *to save* (*sejvoj*)-*ruaj*, *password*-*fjalëkalim*, *database* (*dejtabeiz*)-*baza e të dhënave*, *account* (*ëkaunt*)-*llogari*, *network*-*rrjet* etj.

Në fushën digjitale, termat që përdoren për të përshkruar konceptet që kanë të bëjnë me internetin, rrjetet sociale, sigurinë kompjuterike dhe privatësinë në internet përdoren në gjuhën angleze: *firewall*, *phishing*, *cookie*, *hashtag*. Po ashtu, termat e teknologjisë dhe të informacionit përdoren në gjuhën angleze: *laptop* (laptop) *smartphone* (smartphone),³⁷ *tablet* etj.

Në një masë të madhe e gjithë terminologjia e lidhur me mediat sociale është e huazuar nga anglishtja, duke nisur me emrat e platformave dhe aplikacioneve të ndryshme, të cilat shqiptohen nga shqiptarët sipas shqiptimit të tyre në gjuhën angleze: *Facebook* (*fejsbuk*), *Instagram* (*instagram*), *Twitter* (*tuiter*), *Whatsapp* (*uotsap*), *Viber* (*vajber*), *Twitter* etj. Terminologjia e përdorur për të përshkruar veprimet dhe ndërveprimet në platforma si FB, përdoren pjesërisht në anglisht: *like* (lajk), *share* (shejr), *story* (stori) etj. Po ashtu, huazime

³⁶ Shqiptimi i fjalëve në përdorimin e përditshëm në gjuhën shqipe.

³⁷ Për termin *smartphone* ka dhe një përpjekje për ta zëvendësuar me fjalët e shqipes: *telefon i mençur*.

nga anglishtja janë dhe fjalët si: *selfie, blog, stream, vlog, hashtag, influencer* etj.

Studiuesi Nuhi Vejsiu në studimet e tij ka nxjerrë në dukje dhe ndryshimet fonetike që pësojnë fjalët e huazuara nga gjuha angleze, në gjuhën shqipe³⁸:

leader ['li:də] > lidër ['lidër], po edhe: lider [li'der],
design [di'zain] > dizajn [di'zajn]; best-seller ['bestselə]
> bestseler [bestse'ler], summit ['sʌmit] > samit [sa'mit],
slogan ['sləʊgən] > slogan [slo'gan], congressman
[ˈkɒŋɡresmən] > kongresmen [kongres'men],
businessman ['biznismən] > biznesmen [biznes'men],
stewardess ['stjuədɪs] > stjuardesë [stjuar'desə], slogan
['sləʊgən] > slogan [slo'gan], chat /tʃæt/, çet /tʃet/, çat
/tʃat/ etj.

Studimet për huazimet nga gjuha angleze në gjuhën shqipe tregojnë për një masë në rritje të numrit të tyre me kalimin e viteve, kur fillojnë të bëhen pjesë e leksikut të përgjithshëm, por dhe për një prirje për t'i zëvendësuar ato me kalkimet e fjalëve të përbëra sipas modeleve të anglishtes, p.sh. *politikëbërje, vendimmarrje, paqeruajtësit*.³⁹

Krahas teknologjisë, termat nga gjuha angleze kanë hyrë edhe në: modë, muzikë, kinema etj. Për huazimet specifike të këtyre fushave në gjuhën shqipe ka studime të veçanta. Studiuesit kanë tërhequr vëmendjen në lidhje me identifikimin e huazimeve të shumta që përdoren sidomos nga të rinjtë në gjuhën e

³⁸ Veseli, N. Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe. ASHAK, faqe 38.

³⁹ Lloshi Xh. Raste ndërhyrjes të huazimeve nga anglishtja. https://albanica.al/studime_filologjike/article/view/3278/3198. Studime filologjike, Nr.1-2, 2011, f.86.

folur të përditshme por dhe në medie të tjera siç janë periodikët, media audiovizive etj.⁴⁰ Në fjalorin e medias janë futur fjalët: *news, live*. Në botën e spektaklit janë huazuar fjalë si: *show, reality show, celebrity, trailer, blockbuster, backstage* etj.

Në ditët e sotme, shumë terma të gjuhës angleze përdoren në media, deri në atë pikë sa po bëhen pjesë integrale e gjuhës së përditshme. Disa nga këto terma përdoren të pandryshuar, ndërsa të tjerët janë përshtatur me fonetikën e gjuhës shqipe.

Sikurse u theksua, Instituti Shqiptar i Medias ka realizuar këtë studim, me fokus monitorimin e përdorimit të fjalëve të huaja në mediat audiovizive, me synimin për të dokumentuar dhe analizuar nga ana statistikore prirjet e përdorimit të fjalëve të huaja në media. Analiza e të dhënave zbulon prirjen e përgjithshme të përdorimit të anglicizmave me kalimin e kohës. Duke kuptuar sasinë dhe masën e kësaj prirjeje mund të hetojmë dhe shkaqet që i bëjnë termat e anglishtes që të jenë më të parapëlqyer.

Në pjesën e mëposhtme do të ndalemi te anglicizmat, vendin që zënë në media dhe prirjen e përdorimit të tyre.

3.1. Frekuenca e përdorimit të anglicizmave në media

Ndryshimet politike që ndodhën në Shqipëri pas viteve '90, sollën ndryshimin e sistemit politik dhe ekonomik, gjë që solli dhe një ndryshim terminologjie të këtyre

⁴⁰ Pata I. Aspekte të kontaktit gjuhësor mes shqipes e anglishtes. Revista "Studime filologjike", Nr.3-4, Tiranë, 2020, f.183.

fushave. Prirja drejt përdorimit të huazimeve u pa dhe si një mundësi për të ndryshuar terminologjinë e ngurtë të periudhës së komunizmit, duke sjellë dhe përdorimin e fjalëve të huaja për koncepte për të cilat fjalët e shqipes ishin në përdorim.

Një nga fjalët e huazuara nga gjuha angleze, e cila filloi të përdorej gjerësisht që në fillim të viteve '90 ishte fjala *lider*. Kjo fjalë filloi të zëvendësonte fjalën *udhëheqës*, e cila përgjatë periudhës së komunizmit ishte ndër fjalët më të përdorura të leksikut politik. Kjo fjalë shpesh identifikohet me Enver Hoxhën: *udhëheqës i madh (i urtë, i shkëlqyer, i shquar, largpamës); udhëheqës i shtetit, i popullit; udhëheqës i proletariatit*. Fjala *udhëheqës* përdorej dhe në të gjitha fushat e tjera të jetës në sistemin komunist: *udhëheqës pionierësh, udhëheqës i çetës, udhëheqës artistik* etj.

Në vitet e para të ndryshimit të sistemit politik, brezat e shqiptarëve të rritur me terminologjinë e ligjërimit politik të sistemit komunist, e lidhnin këtë fjalë me terminologjinë e komunizmit dhe është i kuptueshëm zëvendësimi i saj me fjalën *lider* për të treguar dhe një qasje perëndimore.

Por, me kalimin e viteve, fjala *udhëheqës* duket se e ka humbur ngjyrimin e fortë politik dhe është rifutur në ligjërimit politik, duke u përdorur krahas fjalës *lider*.

Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe të vitit 1980, fjala *lider* nuk është e përfshirë, kurse në Fjalorin e vitit 2020, për fjalën *lider* jepet ky përkufizim: "*udhëheqës i lartë, zakonisht i një partie a i një organizate politike*". Pra, fjala, *lider* mund të konsiderohet si një sinonim i pjesshëm me fjalën *udhëheqës*, pasi sikurse u përmend më sipër, kjo fjalë përdoret në disa kuptime:

1. *Ai që drejton nga ana ideologjike e politike një vend, një parti, një klasë ose një lëvizje shoqërore, prijës. Udhëheqës politik (ideologjik).*
2. *Ai që organizon e drejton veprimtarinë e një organizate, të një ndërmarrje a institucion, të një rrethi, të një grupi njerëzish etj.; që kujdeset për mbarrëvajtjen ose për përparimin e dikujt a të diçkaje, ai që drejton një punë e që jep udhëzimet kryesore, drejtues. Udhëheqës artistik. Udhëheqës shkencor.*

Këto dy terma përdoren si sinonime të plota në rastet mëposhtme:

24 korrik 2023 (Panorama) Kompanitë duhet të kenë licencë nga lider botërorë.

23 korrik 2021 (Panorama) Krahas gazetarëve, nën përgjim kanë qenë edhe disa udhëheqës botërorë, sikurse Presidenti francez Emmanuel Macron.

22 shkurt 2025 (Balkanweb) Friedrich Merz, lideri i Partisë Demokristiane ka arritur të fitojë zgjedhjet e përgjithshme në Gjermani dhe do të bëhet kancelar i ri i vendit.

24 shkurt 2025 (Balkanweb) Udhëheqësi i saj, Merz, pritet të nisë tani bisedimet për të zgjedhur partnerin e koalicionit.

Duhet theksuar fakti se fjala *lider* përdoret dhe si sinonim për fjalën *drejtues*: *lideri i partisë, drejtuesi i partisë*. Por fjala *drejtues* është shmangur nga ky monitorim, pasi haset dhe në kuptime të tjera: *drejtues mjeti, këshilli drejtues* etj.

Për të vlerësuar prirjen e sotme të përdorimit të këtyre dy fjalëve në media, në tabelën 25 është paraqitur

frekuenca e përdorimit të këtyre dy fjalëve në katër mediat e analizuar në këtë studim:

Balkanweb.com, Euronews.al, Panorama.com.al, TvKlan.tv.

Tabela 25. Numri i përdorimit të fjalëve: lider udhëheqës⁴¹

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
lider	3580	7916	6830	2086
lideri	6860	2992	8330	3658
liderin	2280	657	2900	1068
liderit	4130	854	3800	1510
liderë	1600	4229	2020	993
liderëve	3070	1370	3450	1879
liderësh	10	32	106	83
liderët	6950	2783	6280	3515
liderat	10	17	106	48
lidera	16	31	65	12
liderave	6	5	21	9
liderash	0	0	5	1
udhëheqës (njëjës dhe shumës)	3430	3651	3290	1339
udhëheqësi	3590	2653	3690	1439
udhëheqësit	5820	1493	5360	2639
udhëheqësin	781	254	1080	434
udhëheqësve	1850	416	2150	911
udhëheqësish	6	13	80	28

Nga analiza e të dhënave të monitoruara, rezulton se mbizotëron fjala *lider*, në të gjitha trajtat e lakimit. Sigurisht që raporti i përdorimit të fjalëve *lider* dhe *udhëheqës* është i ndryshëm në këto katër media. Shihet se te *Panorama* dhe *TvKlan*, përdorimi i fjalës

⁴¹ Të dhënat janë monitoruar më datë 8 mars 2025.

lider është gati dy herë më i lartë nga përdorimi i fjalës *udhëheqës*. Në faqen *euronews.al*, përdorimi i fjalës *udhëheqës* është shumë herë më i vogël nga fjala *lider*, kurse në faqen *www.balkanweb.com* ka një prirje drejt një përdorimi më të drejtpeshuar mes këtyre dy fjalëve, sikurse shihet nga Tabela 26.

Tabela 26. Numri i përdorimit të fjalëve: *lider udhëheqës*⁴²

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
<i>lider</i> (në të gjitha trajtat)	19582	20886	31013	14861
<i>udhëheqës</i> (në të gjitha trajtat)	11887	2176	16280	6790

Bashkë me fjalën *lider*, nga anglishtja është huazuar dhe fjala *leadership*, e cila, po ashtu, e ka fjalën gjegjëse në shqipe: *udhëheqje*.

Në Fjalorin e Shqipes (2020), për fjalën *leadership* është dhënë ky përkufizim: “Udhëheqja e lartë, zakonisht e një partie a e një organizate politike, udhëheqësia.”

Nga monitorimi i katër mediave⁴³, rezulton një përdorim fare pak më i lartë i fjalës *leadership*, sikurse shihet nga të dhënat e paraqitura në Tabelën 27, në krahasim me fjalën *udhëheqje*.

Tabela 27. Numri i përdorimit të fjalëve: *leadership udhëheqje*⁴⁴

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
<i>leadership</i>	344	604	672	287
<i>leadershipi</i>	1290	512	1920	473
<i>udhëheqje</i>	226	711	576	184
<i>udhëheqja</i>	968	165	1610	352

⁴² Të dhënat janë monitoruar më datë 8 mars 2025.

⁴³ Të dhënat janë monitoruar më datë 24 mars 2025.

⁴⁴ Të dhënat janë monitoruar më datë 8 mars 2025.

Fjalët *leadership* dhe *udhëheqje* përdoren si në lajmet nga vendi, ku këta terma përdoren nga vetë politikanët shqiptarë, dhe në lajmet nga bota, ku termi *udhëheqje* përdoret si fjala gjegjëse e fjalës anglisht *leadership* në tekstet e përkthyer nga shtypi i huaj, pa pasur ndonjë ndryshim në përdorimin e tyre.

1 korrik 2024 (Panorama) Hungaria merr kryesimin, ç'pritet nga udhëheqja e saj me BE-në

30 maj 2024 (Euronews) Pas kësaj, udhëheqja lokale ka nisur të ndërtojë një “mur” nga ana veriore e urës, i cili më pas është shembur.

1 shtator 2024 (TvKlan) Lidershipi ynë duhet të zbatojë këto sugjerime apo udhëzime të partnerëve tanë.

11 janar 2025 (Balkanweb) Lidershipi juaj i rëndësishëm në NATO e BE.

➤ *miting&samit*

Ndër 1000 fjalët më të përdorura të fjalorit politik të BE-së janë *meeting* dhe *summit*.⁴⁵ Shqipëria, prej shumë vitesh është në procesin e integritetit në BE dhe është pjesëmarrëse aktive në aktivitetet që organizohen nga institucionet e Bashkimit Evropian. Mediat pasqyrojnë të gjitha fushatat zgjedhore, mbledhjet e rëndësishme, ceremonitë, aktivitetet politike etj. prandaj përdorimi i një leksiku të caktuar është i pashmangshëm. Kështu, në ligjërimin politik të shqipes ka zënë vend termi *samit*. Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe (2020), përkufizimi i dhënë për termin *samit* është: *mbledhje e kryetarëve të shteteve*.

⁴⁵ 1000 words from EU political discourse - Vocabulary List | Vocabulary.com

Frekuenca e përdorimit të këtij termi në media varet nga numri i mbledhjeve që organizohen në nivele të ndryshme. Të dhënat e Tabelës 28 tregojnë për një përdorim të dendur të termit *samit*, gjë që mund të shpjegohet me numrin më të lartë të organizimeve të takimeve të tilla, në nivel botëror.

8 korrik 2016 (Balkanweb) *Samiti i ardhshëm i NATO-s në Bruksel në 2017.*

11 korrik 2017 (Panorama) *Samiti i Triestes si sinjal optimizmi për Ballkanin.*

7 mars 2025 (TvKlan) *Unitet në Samitin e BE-së për Ukrainën.*

11 nëntor 2024 (Euronews) *Samiti për klimën nis punimet në Azerbajxhan.*

Tabela 28. Numri i përdorimit të fjalëve: *samit*⁴⁶

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
samit	1940	3022	1540	1707
samiti	3080	2731	2400	1909

Huazimi *miting*, i përkufizuar në Fjalorin e Shqipes (2020) si “*mbledhje masive në shesh të hapur, ku mbahen fjalime etj.*” përdoret në një numër më të kufizuar rastesh se termi *samit*, edhe pse në të folurit e përditshëm kjo fjalë përdoret më shpesh, në kuptimin e një morie njerëzish, si p.sh. *miting me njerëz*. Në media, rastet më të shpeshta të përdorimit të kësaj fjale, janë në lajmet për aktivitetet politike të partive të ndryshme politike shqiptare kryesisht në Shqipëri, por dhe për aktivitetet e partive politike në vende të ndryshme evropiane dhe në botë.

⁴⁶ Të dhënat janë monitoruar më datë 24 mars 2025.

22 mars 2012 (Panorama) Miting festiv për një mandat të shkuar qeverisë.

17 shtator 2011 (Panorama) Ilirida, paralajmërime për miting masiv në Shkup.

27 tetor 2024 (Euronews) Nëntë ditë nga zgjedhjet, Trump miting në Manhatan, Harris në Filadelfia.

22 shkurt 2025 (TvKlan) Në mitingun përmbyllës të zhvilluar në Dortmund, kancelari Olaf Scholz nuk i kurseu shigjetimet për Uashingtonin.

Edhe pse nuk mungojnë rastet e përdorimit të fjalës *miting* për aktivitetet e partive politike në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi, ky numër është shumë i ulët, pasi atje përdoret kryesisht termi *tubim* “mbledhje njerëzish; kuvend”. Fjala *tubim* është e krijuar nga *tuboj*, e cila vjen prej fjalës *tubë* ‘grup, tufë’, *fjalë e mbarë gjuhës, që lidhet me rrënjën indoevropiane tũ (fryhem)*.

Të dhënat e Tabelës 29, tregojnë një përdorim më të dendur të fjalës shqipe *tubim* në krahasim me fjalën *miting*, në të gjitha mediat e analizuar.

Tabela 29. Numri i përdorimit të fjalëve: *miting tubim*⁴⁷

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
miting	256	355	710	654
mitingu	924	165	397	338
tubim ⁴⁸	1220	1386	1440	744
tubimi	627	654	1210	465

Fjalët *tubim* dhe *miting* përdoren si sinonime të plota në të gjitha rastet e analizuar.

⁴⁷ Të dhënat janë monitoruar më datë 24 mars 2025.

⁴⁸ Të dhënat janë monitoruar më datë 31 mars 2025.

21 dhjetor 2024 (Balkanweb) Tubimi i PD-së, reagon policia: Protesta paqësore e mirëpritur!

13 prill 2014 (Panorama) Policia: Tubimi ishte pa leje.

12 mars 2025 (Euronews) Beograd/ Tubimi në 15 mars, studentët kërkojnë paqe, qeveria paralajmëron dhunë.

17 mars 2025 (TvKlan) Tubimi është thirrur nga grupi i të rinjve "Kush është i radhës?" në shenjë solidarizimi me familjarët e viktimave,

Duhet të vihet në dukje se në statistikën e paraqitura në Tab.29, janë përfshirë dhe raste të përdorimit të kësaj fjale si pjesë e emërimit të partisë franceze të ekstremit të djathtë Tubimi Kombëtar. Kështu, në lajmet e TvKlan-it, 38 raste të përdorimit të fjalës tubim janë si pjesë e emërimit Tubimi Kombëtar.

8 korrik 2024 (TvKlan) Jordan Bardella, udhëheqës i partisë së ekstremit të djathtë në Francë, Tubimi Kombëtar, do të kryesojë një grupim të ri të krahut të djathtë në Parlamentin Evropian,

6 janar 2025 (Balkanweb) Themeluesi i partisë së Frontit Kombëtar Francez (tani i quajtur Tubimi Kombëtar), Jean-Marie Le Pen, ka vdekur në moshën 96-vjeçare.

21 shkurt 2025 (TvKlan) Ligjvënësit nga partia e ekstremit të djathtë Tubimi Kombëtar abstenuan.

10 korrik 2024 (Panorama) Tubimi Kombëtar fitoi rreth 32% të votave në Francë.

➤ *start*

Një huazim i gjuhës angleze i përfshirë në Fjalorin e vitit 1980 është fjala *start*, e cila jepet me përkufizimin e mëposhtëm:

START m.

1. sport. Vija ku rreshtohen sportistët dhe prej nga nisen për të filluar një garë; vendnisje, nisje;
2. sport. Shenja që jepet, zakonisht me një të shtënë arme ose me një lëvizje të dorës, për fillimin e një gare sportive. U dha starti i nisjes së stafetës.
3. sport. Nisje a fillim i një gare sportive. Start i mbarë. Janë gati për start.
4. av. Vendi ku qëndron gati për nisje dhe ku fillon ngritjen një mjet fluturues; çasti kur niset një mjet fluturues. Aeroplanët prisnin në start. U dha sinjali i startit.
5. fig. libr. Nisje e një pune, fillim i diçkaje me rëndësi. Si start i punës sonë. Start drejt betejash të reja.

Ky huazim vijon të përdoret në të njëjta kuptime në lajmet në mediat e analizuara, por kryesisht gjendet i përdorur në kuptimin figurativ “*nisje e një pune, fillim i diçkaje me rëndësi.*”

25 mars 2025 (Balkanweb) Anglia perfekte në start, Tuchel-Kane: Jemi të kënaqur, po vijmë.

18 shkurt 2022 (Panorama) Federata shqiptare e veteranëve në start të mbarë.

1 mars 2025 (TvKlan) Takimi Trump-Zelensky, “starti” i një krize të thellë mes SHBA-ve dhe Europës?

Një numër i shtuar i rasteve të përdorimit të fjalës *start* është prej formulimeve të tipit *start up*, të cilat janë bërë pjesë e terminologjisë së biznesit: “Një kompani inovative ose e drejtuar nga teknologjia, e themeluar brenda 10 viteve të fundit dhe që ka teknologjinë në thelb të modelit të saj të biznesit.”

10 maj 2022 (Euronews) 10 mln euro grante për Start Up-et.

14 dhjetor 2024 (Balkanweb) Numri i aplikuesve ishte më shumë se 500 dhe kemi financuar 94 start up-e në shumë sektorë.

Tabela 30. Numri i përdorimit të fjalëve: *start* ⁴⁹

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
start	1350	1391	4060	551

➤ *startoj filloj, nis*

Krahas huazimit të emrave, në gjuhën shqipe janë huazuar dhe folje të gjuhës angleze. Një nga foljet e huazuara është *to start*, e cila në shqip përdoret me anë të prapashtesës -o, *startoj*.

Folja *startoj*, përdoret dhe në fjali me fjalët e tjera të huazuara *samit* dhe *miting*:

9 dhjetor 2021 (TvKlan) Starton samiti virtual për demokracinë.

Në mediat e analizuara, folja *starton* gjendet e përdorur në gjitha kategoritë e lajmeve nga vendi dhe bota: *politike, kulturore, sportive* etj.

2 prill 2020 (Panorama) OBSH starton monitorimin dhe analizimin e reagimit të vendeve ndaj COVID-19

⁴⁹ Të dhënat janë monitoruar më datë 31 mars 2025.

7 nëntor 2024 (TvKlan) Starton të premten në Tv Klan “X Factor”.

20 tetor 2024 (Balkanweb) Starton maratona e Tiranës, vrapuesit nisin garën në 4 kategori!

13 nëntor 2024 (TvKlan) Starton festivali i verës në Berat, 41 kantina nga Shqipëria e Kosova në Berat

Ndonëse, përshtypja e përgjithshme është që folja *startoj* ka një përdorim të dendur në media, të dhënat e Tabelës 31 tregojnë qartë se mbizotërojnë foljet *filloj* dhe *nis*. *Filloj* është një fjalë formuar nga fjala *fill*, (huazim nga latinishtja). *Folja nis* është fjalë e mbarë shqipes, e dokumentuar që te vepra e Pjetër Budit.⁵⁰

Tabela 31. Numri i përdorimit të fjalëve: *startoj* ↔ *filloj*, *nis*

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
starton	75	68	2670	223
startoi	24	11	392	101
fillon	9410	1952	25000	4659
filloi	12500	2211	18800	5356
nis	27600	- ⁵¹	41400	10000
nisi	17000	-	36300	10000

➤ *bum* (boom)

Një fjalë e gjuhës angleze e cila ka gjetur përdorim në fjalorin ekonomik të shqipes është fjala *bum*. Për këtë fjalë, në Fjalorin e Shqipes (2020) jepet përkufizimi i mëposhtëm:

⁵⁰ Topalli K. Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe. Akademia e Studimeve. Albanologjike, Tiranë, 2017, f.1064.

⁵¹ Të dhënat për foljen *nis* në faqen euronews.al nuk janë përfshirë, pasi kërkimet për këto folje përfshinin dhe fjalë të tjera që kanë në përbërje *nis*.

bum,-i emër i gjinisë mashkullore; numri shumës; -e(t)

1. term në ekonomi; rritje e menjëhershme e prodhimit me mjete të ndryshme për të përballuar krizat.

2. kuptim i figurshëm; i ligjëritimit libror; vërshim a dyndje e diçkaje: bum botimesh.

Ky huazim gjendet i përdorur në dy forma, në formën origjinale *boom*, dhe në trajtën *bum*, ku

fonema angleze e mbyllur e gjatë /u:/ zëvendësohet me /u/ të gjuhës shqipe.⁵²

Tabela 32. Numri i përdorimit të fjalëve: *bum* ↔ *boom*⁵³

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
bum	162	-	832	-
bumi	130	-	142	-
bumin	60	-	68	-
bumit	58	-	68	-
boom	132	70	840	168

Huazimi *bum/boom* përdoret gjerësisht si term në ekonomi për të treguar rritjen në prodhim, turizëm etj.

6 shkurt 2018 (Balkanweb) Bumi i vazhdueshëm ekonomik i Gjermanisë u ka dhënë sindikatave një dorë të fortë në negociatat për paga këtë vit.

29 shtator 2023 (Panorama) “Efekti është i papërfillshëm”-Analiza e BIRN-it: Bumi turistik në Shqipëri dështon të sjellë bum ekonomik.

⁵² Po aty, f.43.

⁵³ Të dhënat janë monitoruar më datë 31 mars 2025.

26 nëntor 2024 (TvKlan) Real Madrid gati për 'boom' financiar.

13 janar 2025 (Balkanweb) Boom turistik/ Viti 2024 solli 11.7 milionë turistë të huaj në Shqipëri, rritje me 15.2 për qind.

Por një përdorim në rritje ka ky huazim në kuptimin e figurshëm “Vërshim a dyndje e diçkaje”: bum/boom turistësh, shitjesh, fitimesh, divorcesh, ndërtimesh etj.

19 korrik 2023 (Euronews) Shqipëria 'boom' turistësh që vizitojnë vendin, 70% e pushuesve nga bota.

9 dhjetor 2024 (Tv Klan) Bayern Munich “boom” fitimesh në 2024.

19 maj 2020 (Balkanweb) COVID-19 “provokon” boom delfinësh në Bosfor

29 maj 2012 (Panorama) Bum arrestimesh në Durrës.

3 prill 2016 (Panorama) Nuk flasim për bum shitjesh, investimesh apo prodhimi.

5 korrik 2024 (Euronews) 'Boom' azilantësh në Shqipëri, dyfishohen kërkesat në 1 vit, shumica nga Afganistani.

22 dhjetor 2019 (TvKlan) “Boom” divorcesh në Gjykatë.

30 gusht 2019 (TvKlan) “Boom” ndërtimesh, 205 leje u dhanë vetëm për 6 muaj në Tiranë.

Sipas Nuhi Veselit “[...] në gjuhën shqipe janë huazuar edhe disa fjalë, që ende nuk e kanë zënë vendin e tyre të denjë me trajtat gjegjëse gramatikore. Një ndër ta që përdoret mjaft shpesh është emri *bum*. Deri tani e kemi hasur vetëm në trajtën e emërores ose kallëzores së pashquar, b.f. “Kjo bëri *bum* të madh” (Rilindja), por

‘nuk na ka rënë’ ta shohim apo ta dëgjojmë në trajtë të shquar.”⁵⁴

Por në mediat e analizuara dëshmohet jo vetëm një përdorim i fjalës *bum* në trajta të ndryshme rasore, por dhe i trajtës së saj në gjuhën angleze, siç shihet në shembujt e mëposhtëm, ku për mbaresat rasore ndahen me anë të vijës, sikurse ndodh në rregullat e drejtshkrimit për shkurtetat.

Po ashtu, këto fjalë herë përdoren mes thonjzave e herë jo, duke treguar mungesë njëtrajtshmërie në përdorimin e tyre.

4 korrik 2019 (TvKlan) *“Boom”-et e Realit dhe Bajernit, ja pse shpenzojnë kaq shumë!*

11 mars 2021 (Panorama) *E kanë parë edhe më herët me boom-in ekonomik të Kilit nën thundrën e autoritarizmit të Pinoçetit.*

5 gusht 2024 (Balkanweb) *Ekonomia madje po rritet për shkak të bumit të armatimeve të lidhura me luftën.*

11 qershor 2024 (Euronews) *Edhe operatorët turistikë e pranojnë bumin e vizitorëve të huaja.*

Fjala *bum* në gjuhën shqipe përdoret dhe si tingullimitim apo onomatope në kuptimet e mëposhtme.

BUM onomat.

1. Përdoret për të shënuar zhurmën që del kur godasim një daulle a diçka tjetër, krismën e një arme të rëndë, përplasjen e fortë të një trupi etj.; bam.

⁵⁴ Veseli, N. Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe. ASHAK, f. 80.

2. përd. kallëzues. Shënon në fjali veprimin e një goditjeje a të një përplasjeje me zhurmë të mbytur.

3. përd. kallëzues. Shënon një veprim që kryhet papandehur (kur dikush vjen papritur, kur diçka shfaqet befas etj.). Kur bum! në dhomë ai.

4. përd. ndajf. Befas, papritur; drejtpërdrejt, copë. Ia tha bum. Më erdhi bum. Ia zuri derën bum.

5. si pj. Përdoret si fjalë nxitëse.

* Bam e bum.

Të dhënat e Tabelës 32 përfshijnë dhe raste të kufizuara të përdorimit të fjalës *boom/bum* si tingullimitim.

20 shtator 2024 (Panorama) Video “Boom boom” Uzuni, sulmuesi shqiptar shënon golin e dytë radhazi në kampionat.

13 mars 2025 (Balkanweb) Tregu i jahteve luksoze po përjeton një bum të paprecedentë, me çmimet që arrijnë nivele që deri vonë dukeshin joreale.

22 janar 2025 (Balkanweb) Zyrtare/Dy goditje në merkato, Partizani bën “boom”.

Në të dhënat statistikore të përgjithshme të përdorimit të fjalës *boom* janë përfshirë dhe raste të përdorimit të saj:

- Si emërtim i emisionit televiziv të televizionit Ora News. Kështu, në faqen e Panoramës janë 35 raste përdorimi të fjalës në grupin e fjalëve: *emisioni “BOOM”*

31 janar 2017 (Panorama) Emisioni “BOOM” në Rtv Ora News, e ka monitoruar me kujdes këtë proces.

- Në titullin e këngës “Boom Boom”

3 qershor 2018 (Panorama) Kjo këngë u këndua mbrëmë e çdo herë Flor, është kënga Boom Boom, ku ndërthurëm modernen me folkun.

- Në emrin e radios “Boom Boom”

18 korrik 2012 (Panorama) Organizatorët e këtij viti janë shoqata kulturore “Syri blu” dhe “Boom boom radio”, me mbështetjen e Bashkisë së Tiranës.

- Në emërtimin ‘baby boom’ që i referohet rritjes së lindshmërisë, por dhe brezit të lindur në vitet ’60-’70. Kështu, në faqen e Balkanweb-it janë 7 raste të tilla përdorimi.

25 tetor 2023 (Balkanweb) Në këtë periudhë po del në pension brezi i “baby boom”, (të lindur në vitet 1960-1970).

- Në emërtimin e kompanisë “Boom Supersonic” (10 raste përdorimi në Balkanweb)

4 mars 2025 (Balkanweb) Themeluesi dhe CEO i Boom Supersonic, Blake Scholl tha se imazhi e bën të padukshmen të dukshme.

➤ *bojkotoj*

Në listën e huazimeve të anglishtes të përfshira në Fjalorin e Shqipes së Sotme të vitit 1980, është dhe folja *bojkotoj*. Përkufizimi i kësaj fjale dhe shembujt e dhënë, tipikë të periudhës së komunizmit, janë ndryshuar në fjalorët e mëpasshëm, duke e përkufizuar si:

bojkot/ój folje kalimtare; -óva, -úar i ligjërimit libror; ndërpres lidhjet me organet shtetërore, me ndonjë

organizatë etj., nuk u shërbej më; largohem nga një veprimtari a nuk marr pjesë kur jam i pakënaqur me të; i shmangem diçkaje: bojkotuan zgjedhjet. / trajta pësore; bojkotohem.

Kjo folje përdoret kryesisht në lajmet për Kuvendin e Shqipërisë, nga politika e jashtme etj.

6 nëntor 2023 (TvKlan) Bojkotohet mbledhja te 'Ligjet'

7 mars 2024 (Balkanweb) Peticioni është nënshkruar edhe nga përfaqësuesit e Listës Serbe, parti që bojkotoi zgjedhjet e prillit të vitit 2023.

22 dhjetor 2024 (Panorama) Opozita në Mal të Zi bojkoton Parlamentin për shkak të Gjykatës Kushtetuese.

19 dhjetor 2024 (Euronews) Procesi edhe në atë kohë ishte bojkotuar në masë të madhe nga serbët.

Tabela 33. Numri i përdorimit të foljes: bojkotoj⁵⁵

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
bojkoton	227	126	495	151
bojkotoi	227	61	293	118
bojkotuar	818	214	896	451
bojkotohet	72	24	87	31

➤ *spiker/folës*

Huazimi nga gjuha angleze *spiker* është përfshirë në Fjalorin e Shqipes së Sotme të vitit 1980, me përkufizimin:

⁵⁵ Të dhënat janë monitoruar më datë 25 mars 2025.

SPIKER m.

1. Ai që jep lajmet, lexon programet etj. në radio ose në televizionin folës. Spikeri i radios.

2. Ai që njofton numrat e programit në një shfaqje artistike. Spikeri i estradës (i koncertit).

Ndonëse në Fjalorin e Shqipes, nuk janë dhënë të gjitha kuptimet e saj, në gjuhën angleze, fjala *spiker* përdoret në të njëjtin kuptim me fjalë shqipe folës: a. *Një person që mban një fjalim në një event publik.* b. *Një person që flet një gjuhë të caktuar.*

Në shqip, fjala *spiker* është përdorur kryesisht në kuptimin e parë të dhënë në fjalorin e shqipes (*spiker lajmesh*), duke qenë kështu një sinonim i pjesshëm i fjalës shqipe folës.

21 shtator 2021 (Balkanweb) Sassoli, një ish gazetar dhe spiker lajmesh, u zgjodh eurodeputet në 2009 me qendrën e majtë.

12 nëntor 2011 (Panorama) Folësi i lajmeve jo të zakonshme në “Top Channel” tregon për eksperiencën e re.

24 qershor 2024 (Balkanweb) Jeff Bezos dhe spikerja e lajmeve Lauren Sanchez dolën publikisht me lidhjen e tyre në vitin 2019.

5 qershor 2017 (Panorama) Folësja ikonë e Radio Televizionit Publik Shqiptar, ka lënë përgjithmonë Shqipërinë.

Por huazimi *spiker* përdoret dhe në kuptimin tjetër të fjalës folës ‘Ai që flet për diçka në një mbledhje të gjerë, ai që mban një fjalim ose që bën një diskutim.’ në kombinime si: folës kryesor, folës publik etj.

25 shkurt 2017 (Panorama) Spiker kryesor ishte studiuesi amerikan Dalibor Rohac, i cili tha se, duhet të kuptojmë se çfarë është populizmi i vërtetë.

6 nëntor 2020 (Panorama) Cawthorn konsiderohet si një folës motivues.

Fjala *spiker* nuk përdoret si sinonim me fjalën *folës* në kuptimin “një person që flet një gjuhë të caktuar”.

23 maj 2024 (Balkanweb) Arbanasi, i themeluar në fillim të shekullit të 18-të nga refugjatë nga rajoni rreth qytetit bregdetar malazez të Tivarit, ka rreth 2000 folës.

Të dhënat e Tabelës 34 tregojnë një numër shumë të madh përdorimi të fjalës *spiker* në televizionin Klan. Kjo vjen pasi për çdo edicion lajmesh në Tv Klan jepet dhe emri i spikerit: p.sh.

Lajme, #edicioniinformativ ora 19:30, 30 Mars
2025 #TvKlan #klanlajme
Spiker: Anjola Hamzaj

Përdorimi më i madh i trajtave të shumësit *folës/folësit* vihet re në lajmet për organizimet e ndryshme politike, takime etj., ku folës të ndryshëm mbajnë fjalën e tyre para pjesëmarrësve.

11 korrik 2024 (Euronews) Zbulohet se kush do të jenë folësit në protestën e opozitës.

25 janar 2025 (Panorama) Folës nga Tirana, Tropoja e diaspora, veçuan tipare të romane të shkrimtarit, ish-diplomatit e ish- ministrit.

Tabela 34. Numri i përdorimit të fjalëve: *spiker* ↔ *folës* ⁵⁶

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
spiker	5	36	51	10000
spikeri	16	8	112	48
spikerët	40	1	47	2
spikere	26	20	88	244
spikerja	20	13	409	78
folës	44	330	274	91
folësi	15	71	89	17
folësit	185	60	211	69
folëse	26	127	131	65
folësja	4	5	27	5

➤ *show, showbiz*

Në ligjërimin mediatik, kanë zënë një vend të veçantë, huazimet e gjuhës angleze: *show, showbiz, showgirl, reality show, talk show* etj.

Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe (2020), fjala *shou* (*show*) është futur si një fjalë e palakueshme me kuptimin “shfaqje artistike e gëzueshme. E bën për *shou*.”

Ky term haset në emërtimet e programeve të ndryshme televizive: *Aldo Morning Show (TvKlan), Ag Show (Top Channel)* etj.

Në familjen e fjalëve të gjuhës angleze të formuar me anë të fjalës *show* hyn dhe fjala *show-business*. Kjo fjalë, në formën e saj sintetike *showbiz* është bërë pjesë e fjalorit të botës së spektaklit të shumë gjuhëve, përfshirë këtu dhe gjuhën shqipe.

⁵⁶ Të dhënat janë monitoruar më datë 31 mars 2025.

Kategoria *showbiz* gjendet në disa nga faqet e internetit të medias shqiptare: *www.topchannel.tv*, *www.syri.net*, *newsbomb.al*, *tvklan.al* etj.

Të dhënat e Tabelës 35 dëshmojnë një numër shumë të madh përdorimi të huazimit të fjalës së gjuhës angleze *show*.

Tabela 35. Numri i përdorimit të fjalëve: *show* ↔ *showbiz* ⁵⁷

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
spiker	5	36	51	10000
spikeri	16	8	112	48
spikerët	40	1	47	2
spikere	26	20	88	244
spikerja	20	13	409	78
folës	44	330	274	91
folësi	15	71	89	17
folësit	185	60	211	69
folëse	26	127	131	65
folësja	4	5	27	5

Në mediat e monitoruara, ky huazim përdoret:

– në kuptimin *shfaqje artistike*

16 shtator 2012 (Panorama) Ky show është një “lojë televizive” amerikane që transmetohet në prime time nga 14 marsi i vitit 2010, i mbajtur nga Guy Fieri.

– në kuptimin *shfaqje* (E bën për shou).

1 mars 2025 (Balkanweb) Skënderbeu dhuron show në Ballsh, fiton pastër ndaj Bylis.

⁵⁷ Të dhënat janë monitoruar më datë 31 mars 2025.

27 qershor 2021 (Panorama) Video/"Fluturimi" nga anija në det, Ibra dhuron "show" kudo.

15 shkurt 2025 (Balkanweb) Kosova/ Barazim dramatik, Prishtina dhe Drita dhurojnë show

– si pjesë e emërimit të shfaqjeve të ndryshme

31 janar 2012 (Panorama) Platinette flet për Shqipërinë tek Chiambretti show.

20 dhjetor 2024 (Euronews) Vodafone sjell "5G HoloShow" në TEG, një dimension i ri argëtimi.

16 shtator 2017 (Balkanweb) Nicky Minaj, ekstravagante në Tonight Show.

5 tetor 2013 (Panorama) "Zhurma Show Awards", spektakli që mbledh VIP-at, ja paskuintat

– në fjalën *showbiz*

30 mars 2018 (Panorama) Vetëm 4 muaj, ja martesa më e shkurtër e showbiz-it shqiptar.

30 shtator 2021 (Euronews) Që nga njerëzit e parë që më mbështetën, pa të cilët nuk do të bëja asnjë hap kur të bashkohesha me showbiz-in.

– në fjalën *talk show*, që përdoret për të emërtuar një program televiziv në radio ose në televizion, që ka synim diskutimin mes personave të ndryshëm për një çështje të caktuar.⁵⁸ Ky term përdoret në mediat shqiptare në shpjegimet që jepen për programet televizive në faqet e internetit të mediave të ndryshme, në lajme etj.

⁵⁸ TALK SHOW | English meaning - Cambridge Dictionary.

(Top Channel) Për'Puthen është një talk show dashurie, i cili sjell histori të vërteta dhe të gjalla të njohjeve mes të rinjve.

16 janar 2020 (Panorama) Rënia e "talk show"-t shqiptar?

16 nëntor 2024 (TvKlan) O'Brien, i cili ka fituar pesë çmime "Emmy" për serialet e tij jo-fiction dhe talk show-t, do të jetë prezantuesi i vetëm i "Oscars"

– në fjalëformimin reality show që përdoret për të emërtuar një shfaqje në televizion, ku pjesëmarrësit filmohen në përditshmërinë e tyre ose duke ndërmarrë sfida të veçanta.

20 mars 2025 (Balkanweb) Hilaria Baldwin ka folur për mediat lidhur me mundësinë që TLC të xhironte një sezon të dytë të reality show-t të tyre, "The Baldwins".

30 janar 2024 (TvKlan) Ylli i Reality show, Kim Kardashian do të jetë producente ekzekutive.

– si pjesë e emërtimit 'show room' (dyqan i madh ku bëhet reklamimi i produkteve të ndryshme). Ky term haset nw artikuj e shkruar si reklama pwr kompani tw ndryshme.

22 prill 2014 (Panorama) Do të ndërtohet një "show room" për prodhuesit.

26 shtator 2024 (Balkanwb) Sirezultat i këtij përkushtimi, Auto Star ka showroom-in më të madh në Ballkan dhe është lider në tregun shqiptar të automobilave.

21 mars 2025 (TvKlan) Auto Flux Fusion hap showroom-in e ri në Tiranë.

17 nëntor 2023 (Euronews) Billa, feston ditëlindjen me hapjen e showroomit të ri.

Sikurse shihet nga shembujt e mësipërm, fjala *show* dhe e gjithë familja e fjalëve e krijuar prej saj duket sa kanë zënë vend në gjuhën shqipe dhe përdoren në trajta të ndryshme rasore. Përsa i përket mënyrës së shkrimit të kësaj fjale, trajta mbizotëruese është ajo origjinale në gjuhën angleze (*show*), ndonëse nuk mungojnë dhe raste të përdorimit të saj sipas shqiptimit në gjuhën shqipe (*shou*).

30 gusht 2018 (Balkanweb) Vetë aktori Liam Neeson ka treguar në një shou se ai ka pranuar letra nga një profesor në Texas.

➤ News

News është një fjalë e gjuhës angleze që ka të bëjë me informacionin për një situatë që ndryshon apo me informacionin që publikohet në gazeta, në radio-televizion për ngjarjet më të fundit nga vendi dhe bota.⁵⁹

Disa nga mediat më të rëndësishme në Shqipëri kanë në emërtimin e tyre pikërisht këtë huazim nga anglishtja: *Fax News, TV Ora News, ABC News, Euronews, News 24, Top News, Klan News*.

Përdorimi i këtij huazimi në emërtimet e mediave të ndryshme shpjegon dhe numrin shumë të lartë të përdorimit të tij në të katër mediat e monitoruara, por në mënyrë të veçantë në *Balkanweb (News 24)* dhe *Euronews*.

⁵⁹ NEWS definition and meaning | Collins English Dictionary.

Tabela 36. Numri i përdorimit të fjalës: News

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
news	117000	107693	27600	10000

Huazimi *News*, në mediat e monitoruara është përdorur në:

– Emërtimet e mediave të ndryshme vendase dhe të huaja

8 janar 2025 (Balkanweb) Media irlandeze “The Irish News”: Shqipëria ndër destinacionet më të mira për pushime në 2025.

28 shkurt 2023 (Panorama) Pronari i Fox News-it pranon se disa prezantues televiziv përkrahën pretendimet e rreme mbi zgjedhjet.

– në emërtimin “Breaking News”, një shprehje që përdoret për lajmin e minutës së fundit. Ky term është përdorur dhe në lajmet të cilat janë marrë direkt nga mediat e huaja dhe janë dhënë brenda tekstit në variantin original në gjuhën angleze.

25 gusht 2016 (Panorama) Ngjarja kriminale që pulson nën vezullimin “Breaking News” është thjesht rutina e radhës.

– Si pjesë e emërtimit “Fake News”, një shprehje që është bërë e njohur për të përshkruar lajme të pavërteta që dezinformojnë publikun. Kështu, në faqen panorama.com.al janë 246 raste përdorimi të kësaj fjale. Kjo fjalë haset e shkruar si në gjuhën angleze (fake news), por edhe si një fjalë e vetme (fakenews).

2 dhjetor 2020 (Panorama) Covid 19, fake news dhe sfida e mjekëve për informim.

27 prill 2018 (Panorama) Fakenews dhe problemet e medias sot, tryezë me gazetarët dhe pedagogët.

➤ *Live*⁶⁰

Fjala *live* në anglisht ka disa kuptime, por në huazimet në gjuhët e tjera dhe në gjuhën shqipe ka hyrë kryesisht në kuptimin e një shfaqjeje, transmetimi, regjistrimi, që shihet ndërsa është duke ndodhur”.⁶¹

Gjatë viteve të fundit, është një nga fjalët që përdoret më shumë në mediat shqiptare. Rastet e larta të përdorimit të huazimit *live* për mediat Panorama dhe Balkanweb (Tabela 37), mund të arsyetohen me transmetimet e drejtpërdrejta të këtyre mediave me emërtimet: *News 24 live*, *News 24 live stream*, *Panorama TV Live Stream*. Një frekuencë të lartë përdorimi ka dhe informacioni i përsëritur për emisionin *Opinion* në TV Klan (#Opinion | Emision politik live). Euronews ka dhe një kategori në faqen e internetit (Live).

Po ashtu, transmetimet e drejtpërdrejta të mediave të analizuara, vendosen nën kategorinë *live*:

21 mars 2025 (Balkanweb) LIVE/ Angli-Shqipëri, nis ndeshja kualifikuese e Botërorit.

29 tetor 2024 (Euronews) VIDEO-LIVE| 6 akse të paralizuara, nis bllokimi i rrugëve për protestën e opozitës.

13 mars 2013 (Panorama) Vatikan, LIVE nga sheshi Shën Pjetri!

⁶⁰ Të dhënat janë monitoruar më datë 25 mars 2025.

⁶¹ LIVE | English meaning - Cambridge Dictionary.

Tabela 37. Numri i përdorimit të foljes: *Live*⁶²

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
live	26200	3806	86000	5526

Ky huazim përdoret jo vetëm në krye të titullit por dhe në brendësi të tij, shpesh i vendosur dhe në thonjëza.

5 nëntor 2024 (Euronews) Nis procesi i votimit në SHBA, ekipi i Euronews Albania live nga qendra e votimit.

26 prill 2021 (Balkanweb) Votimi elektronik, nxirren 'live' rezultatet në Njësinë 10.

16 nëntor 2016 (Panorama) Gazetarja e njohur lind pak minuta pas transmetimit 'live'.

Ky huazim përdoret shpesh në ligjërimin e folur mediatik: (A) *jemi live, komunikojmë live, lexon live, publikon live, transmetim live, mesazh live, lidhje live, konferencë live* etj. Raste të tilla të përdorimit të fjalës *live* mund të shmangen, pasi në të gjitha këto raste janë përdorur fjalët e shqipes *drejtpërdrejt* dhe *drejtpërsëdrejti*.

28 mars 2025 (TvKlan) Argëtim, me muzikë dhe quiz, lojëra gjithëpërfshirëse që të japin atë dëshirën për të luajtur dhe për të komunikuar live me Katerinën dhe të ftuarit e saj.

28 janar 2020 (Balkanweb) Një tërmet, ok! Jemi live.

8 prill 202 (Panorama) Gazetari britanik vonohet në transmetim live.

⁶² Të dhënat janë monitoruar më datë 25 mars 2025.

⁶³ Të dhënat për Euronews janë 3806, por këto të dhëna përfshijnë dhe përdorime të fjalëve që kanë në përbërjen e tyre fjalën *live*, si Liverpool.

14 mars 2020 (Balkanweb) Koronavirusi/ Lidhje 'live' nga Milanoja.

Raste të tjera përdorimit të këtij huazimi lidhen me terminologjinë në të cilën përdoret në kinematografi dhe muzikë: *muzikë live, koncert live, live action* etj.

20 dhjetor 2020 (Balkanweb) Organizonte 'muzikë live' në kundërshtim me masat e COVID-19.

30 mars 2025 (TvKlan) Filmi do të debutojë gjatë fundjavës së Ditës së Përkujtimit të SHBA në Maj, së bashku me versionin live-action të Walt Disney të klasikut të animuar Lilo & Stitch.

➤ Lifestyle⁶⁴

Lifestyle-një fjalë e gjuhës angleze që ka të bëjë me stilin ose mënyrën e jetesës së një individi ose të një shoqërie, është një nga huazimet e reja të gjuhës angleze në gjuhën shqipe. Përdoret shpesh si kategori në media për të reflektuar dhe promovuar një stil të caktuar jete.

Të dhënat e paraqitura në Tabelën 38 tregojnë për një numër shumë të lartë përdorimi të kësaj fjale në faqen e Panoramës, pasi *Lifestyle* përdoret krahas kategorive: *lajme, sociale, opinion, ekonomi, politikë, opinion, aktualitet* etj.

Tabela 38. Numri i përdorimit të foljes: *Lifestyle*⁶⁵

	Balkanweb.com	Euronews.al	Panorama.com.al	Tvklan.tv
Lifestyle	124	16	223000	32

⁶⁴ lifestyle, n. meanings, etymology and more | Oxford English Dictionary.

⁶⁵ Të dhënat janë monitoruar më datë 31 mars 2025.

Në tekstet e lajmeve, ky huazim nga gjuha angleze, përdoret i shkruar në original. Ky huazim përdoret në rastet e mëposhtme:

– brenda fjalive ku fare mirë mund të përkthehet në shqip si *stili i jetesës/të jetuarit* ose *stile jete*:

5 shtator 2018 (Balkanweb) Ky emision transmetohet prej disa vitesh në televizionin “Klan” dhe temat kryesore që trajton janë lifestyle, argëtim, modë dhe intervista me personazhe të njohur të ekranit.

– si pjesë e emërimit të revistave të ndryshme:

3 maj 2024 (TvKlan) Ky është sugjerimi që u bën lexuesve të saj amerikane revista “Traveling Lifestyle” që e rendit vendin tonë në listën e 6 destinacioneve perfekte të kësaj vere.

– si rubrikë në televizion ose në faqet e internetit

30 gusht 2024 (Balkanweb) Informacione utilitare mëngjesi që nga moti e këshillat e fillimititës, rubrikat lifestyle e të jetuarit shëndetshëm [...] (Balkanweb) Të Fundit nga -Life-Style

Përgjithësisht kjo fjalë përdoret në formë të palakueshme, duke treguar që nuk ka zënë në leksikun e shqipes.

3.2 Titujt e emisioneve

Televizioni, si mjeti më i përhapur i komunikimit për një periudhë të gjatë kohe, ka qenë dhe një mjet i komunikimit me ndikim shumë të madh dhe në formimin gjuhësor të teleshikuesve. Gjuha që

përdoret në televizion ndikon në formimin gjuhësor të teleshikuesve, prandaj televizioni duhet të jetë një pikë referimi kulturor. Është i njohur roli që ka pasur Rai në Itali në afirmimin e standardit të italishtes. Rai u krijua për të informuar, argëtuar, por edhe për të edukuar italianët, duke pasur një funksion pedagogjik, duke përhapur italishten standarde, atë të gramatikës, një gjuhë me sintaksë të thjeshtë, por me regjistër të lartë dhe duke bërë që prezantuesit, gazetarët dhe spikeret të ndiqnin kurse të veçanta diksioni për të standardizuar shqiptimet⁶⁶

Që nga viti 1996, televizioni ka ndryshuar, duke e vënë publikun gjithnjë e më shumë në qendër të vëmendjes dhe modeli i gjuhës ka ndryshuar, duke u prirë drejt të folurit të zakonshëm. Italia vazhdon të jetë një nga vendet e pakta në Evropë, ku filmat dublohen në gjuhën italiane, si një përpjekje për të ruajtur gjuhën dhe kulturën italiane.

Media televizive ndikon në gjuhën e përditshme edhe përmes shprehjeve që përdoren në emisione të ndryshme, por dhe përmes titujve të emisioneve më të suksesshme, të cilat përdoren në jetën e përditshme, edhe pse janë kryesisht kalimtare.

Në televizionin italian Rai, vihet re se e njëjta rëndësi u jepet dhe titujve të programeve televizive, të cilat janë kryesisht në gjuhën italiane, edhe pse nën tryshninë e fortë të anglishtes dhe të ndikimit kulturor të medias amerikane, nuk mungojnë dhe rastet e përdorimit të titujve në gjuhën angleze (RaiNews).

⁶⁶ 70 anni di TV in Italia: lingua italiana e televisione - Italofonia.info.

Në krahasim me RAI-n, në televizionet shqiptare ka një prirje më të lartë përdorimi të titujve të emisioneve në gjuhën angleze ose titujve të përzier shqip-anglisht. Televizionet italiane RAI dhe Mediaset i përkthejnë titujt e emisioneve që janë patentat ndërkombëtare në gjuhën italiane: *Big Brother-Grande Fratello*, *Dancing With the stars-Ballando con le stelle*. Ky model mund të ndiqet dhe nga mediat shqiptare. Po ashtu, një pjesë e mirë e titujve të emisioneve të paraqitura në Tabelën 39 mund të tingëllojnë më bukur në gjuhën shqipe dhe të jenë të kuptueshëm për pjesën më të madhe të teleshikuesve shqiptarë, duke pasur parasysh dhe moshën e publikut që ndjek emisionet televizive.

Tabela 39. Titujt e emisioneve⁶⁷

	Anglisht	I përzier (shqip-anglisht)
ABC News	<i>Breaking News, Balkan Update, Real Story, Virtual Wars, War Update, GPS, News Room</i>	
Euronews	<i>Now, Real People, Max Sport, Health o'Clock, Interview, Balkan Talks</i>	
News 24	<i>Fit Station, Log, Open, Podcast, Vetting</i>	
Ora News	<i>Glamour Zone, Why Not, Alien</i>	
RTSH	<i>Millennials Unplugged</i>	<i>Nazarko Podcast</i>
Top Channel	<i>Wake Up; Top Story, Inside Story, Big Brother VIP Albania, Fan Club BBVIP, Top List</i>	<i>Shqipëria Live, Top Talk Ekonomi, Ora News Speciale</i>
TvKlan	<i>Aldo Morning Show, Xfactor, Pro Business, Love Island Albania, Dance Albania, Love Story, Check In</i>	<i>Doktor Plastik</i>
Vizion Plus	<i>E-Zone, Fake off, Living Room, Albania's Got Talent</i>	<i>Papare Najt</i>
Syri Tv	<i>Task Force</i>	<i>Çim Peka Live</i>

⁶⁷ Të dhënat janë monitoruar më datë 31 mars 2025.

PËRFUNDIME

Analiza e të dhënave tregon për një prirje në rritje të përdorimit të huazimeve nga gjuha angleze në median shqiptare. Disa prej këtyre huazimeve kanë zënë vend në gjuhën shqipe, duke u përdorur shpesh si fjalë sinonimike me fjalë të shqipes, edhe pse në shumë raste mund të shmangen dhe të përdoren fjalët e shqipes.

- Nga analiza e të dhënave të monitoruara, rezulton se fjala *lider* mbizotëron, në krahasim me fjalën *udhëheqës* në të gjitha trajtat e lakimit.
- Ka një përdorim fare pak më të lartë të fjalës *leadership* në krahasim me fjalën *udhëheqje*.
- Ka një përdorim të dendur të termit *samit*.
- Huazimi *miting* përdoret në një numër më të kufizuar rastesh se termi *samit*. Ka një përdorim më të dendur të fjalës shqipe *tubim* në krahasim me fjalën *miting*.
- Një numër i shtuar i rasteve të përdorimit të fjalës *start* është prej formulimeve të tipit *start up*.
- Folja *startoj* ka një përdorim jo të dendur. Në media mbizotërojnë foljet *filloj* dhe *nis*.
- Një fjalë e gjuhës angleze e cila ka gjetur përdorim në fjalorin ekonomik të shqipes është fjala *bum*.
- Përdorimi më i madh i trajtave të shumësit *folës/folësit* se huazimi *spiker* vihet re në lajmet për organizimet e ndryshme politike, takim etj.

- Në ligjërimin mediatik, kanë zënë një vend të veçantë, huazimet e gjuhës angleze: *show, showbiz, reality show, talk show* etj.
- Një nga huazimet e gjuhës angleze që përdoret gjerësisht në media është fjala *news*. Disa nga mediat më të rëndësishme në Shqipëri kanë në emërtimin e tyre pikërisht këtë huazim nga anglishtja: *Fax News, TV Ora News, ABC News, Euronews, News 24, Top News, Klan News*.
- Gjatë viteve të fundit, një nga fjalët që përdoret më shumë në mediat shqiptare është fjala *live*.
- *Lifestyle*-një është një nga huazimet e reja të gjuhës angleze në gjuhën shqipe.

Media është një nga mjetet për përhapjen e anglicizmave që po ndryshojnë me shpejtësi gjuhën shqipe. Përdorimi i shprehjeve origjinale në anglisht mund të jetë për arsye *stilistike* apo edhe një mënyrë e thjeshtë komunikimi, duke e përsëritur shprehjen, pa u përpjekur të kërkohet shprehja gjegjëse në shqip. Ka huazime të cilat kanë zënë vend në terminologjinë e medias në shumë gjuhë dhe zëvendësimi i tyre nuk është i lehtë për t'u bërë. Por media mund të luajë një rol më të madh në përdorimin e fjalëve të shqipes në titujt e emisioneve të ndryshme, në kategoritë e faqeve të internetit etj.

BIBLIOGRAFIA:

Kapo (Pata), Irena, *Përshatja morfologjike e anglicizmave në shtypin shqiptar*. European Journal of Language and Literature, [S.l.], v. 9, n. 1, 2018, f. 143-154.

<<http://journals.euser.org/index.php/ejls/article/view/2912>>.

Kapo, (Pata) Irena, *Monografi. Ndikimi i Anglishtes në Shtypin Shqiptar Paskomunist*, Botimet Dritan, Tiranë, 2016; Punim doktore: <https://unitir.edu.al/doktoratura-irena-pata-kapo-fakulteti-i-gjuheve-te-huaja-departamenti-i-gjuhes-angleze/>, Tiranë, 2013, f. 172-173.

Kapo, (Pata) Irena, "Anglicizmat si Neologjizma në shtypin shqiptar që në 1990", *Journal of Educational and Social Research* (0.507), Mediterranean Center of Social and Educational Research', Vol. 6 Nr. 1, 2016.

Këçira, Rajmonda, *Anglicisms in Albanian: A Direct and Mediated Language Contact Phenomenon*, Graz, Instituti i Anglistikës, 2005.

Lloshi, Xhevat, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2001.

Lloshi, Xhevat, Konferenca shkencore *Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot*, Tiranë, 2003.

Lloshi, Xhevat, "Raste ndërhyrjesh të huazimeve nga anglishtja", *Studime filologjike*, nr. 1-2, 2011, f. 63-89.

- Lloshi Xhevat, “Përkthimi shqip nga anglishtja, Vështrime të reja”, *Academia.edu*, 2017.
- Memisha, Valter, *Studime për fjalën shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Botart, Tiranë, 2011.
- Nuhio, Vesel, *Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave, Prishtinë, 2013.
- Omari, Anila, *Vështrim mbi disa prirje të gjuhës së sotme letrare, në: Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*, Aktet e konferencës shkencore – Durrës, 15-17 dhjetor 2010, QSA, IGJL, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2011, f. 173-193.
- Paçarizi, Rrahman, “Fjalëformimi i shqipes – Tipologji, koncepte e dilema”, *Gjurmime albanologjike*, nr. 49, 2019.
- Shehu, Hajri, “Rreth anglicizmave në mjetet e sotme të informimit masiv”, *Studime filologjike*, Tiranë, 2002/3-4, f. 91.
- Thomai, Jani, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, TOENA, Tiranë, 2002.
- Thomai, Jani, Samara, Miço, Haxhillazi, Pavli, Shehu, Hajri, Feka, Thanas, Memisha, Valter, Goga, Artan, *Fjalor i Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Mëniku, Linda

Monitorimi i përdorimit të fjalëve të huaja në mediat
audiovizive / Linda Meniku. - Tiranë : Instituti

Shqiptar i Medias, 2025.

108 f. ; 14x20.5 cm.

ISBN 9789928469564

1.Fjalë dhe shprehje të huaja 2.Gjuha shqipe 3.Përdorimi
dhe pastërtia e gjuhës 4.Masmedia 5.Monitorime

811.18 '27 :659.3

abandonoj, ambient, aplikoj, aprovoj, autokton, dedikoj, densitet, devocion, dimension, fantaz kapriĉio, kapriĉoz, kĕnd, kontribut, komunitet kuadrat, kvalitet, legjislacion, legjitim, m pasagjer, penetroj, portofol, prenotoj, propor apartejd, autostop, bar, basketboll, bejsboll, biznesmen, blister, bluxhins, bluz, bojkot, b boksier, bos, brixh, buldozer, bum, bumerang, b dollar, doping, dragĕ, faull, film, finish, flin golf, grejpfrut, hamburger, handikapat, hendb inĉ, jaht, janki, kauboj, kek, king, klub, kll kongresmen, kontejner, kros, kultivar, laburist, lobizĕm, lokaut, lord, marins, mikser, miting, n penallti, peni , piknik, pop art, pulovĕr, rams sandviĉ, skrap, skreper, slogan, snajper, snob, standard, start, sterlinĕ, stop, stres, stript tank, tenis, trajler, trajner, trejning, trakto uestern, uiski, vat, vaterpolo, volejboll, xhaz abandonoj, ambient, aplikoj, aprovoj, autokton, dedikoj, densitet, devocion, dimension, fantaz kapriĉio, kapriĉoz, kĕnd, kontribut, komunitet kuadrat, kvalitet, legjislacion, legjitim, m pasagjer, penetroj, portofol, prenotoj, propor apartejd, autostop, bar, basketboll, bejsboll, biznesmen, blister, bluxhins, bluz, bojkot, b boksier, bos, brixh, buldozer, bum, bumerang, b dollar, doping, dragĕ, faull, film, finish, flin golf, grejpfrut, hamburger, handikapat, hendb inĉ, jaht, janki, kauboj, kek, king, klub, kll kongresmen, konte kultivar, laburist, lobizĕm, lokaut, s, mikser, miting, n penallti, peni , piknik, pop art, pulovĕr, rams sandviĉ, skrap, skreper, slogan, snajper, snob,

ISBN 978-9928-469-56-4



9 789928 469564 >